

nagip Mahfuz

BIBLIOTEKA

84-32
M 17



E BEKUAR QOFTË MBRËMJA JOTE

novelë

çmimi i NOBEL

8H-32
M 17

NAGIP MAHFUZ

E BEKUAR QOFTE MBREMJA JOTE...

N o v e l ë



Përktheu: LILI BARE

«APOLLONIA», 1993

1.

Sot unë po filloj një jetë të re — jetën e pensionistit.

Pasi kalova vite të tëra pa fund si nëpunës shteti, pasi humba rininë dhe moshën e pjekurisë, shkëla edhe unë, si mjaft të tjerë, pragun e pleqërisë. Nëpunësia shtetërore më mësoi dhe më detyroi t'i mbetem besnik për jetë mbretit si dhe të katër presidentëve¹⁾ që erdhën pas tij. Veç asnjeri syresh nuk e çau kokën për mua. Por s'është fjala për këtë. Por per ca gjëra të tjera; për ca halle më të mëdha e më të ngatërruara që ranë mbi kurrizin tim. Është fjala, shkurt, për vuajtjet që heq unë për shkaka të kujtesës e të fantazisë sime. Ka mjaft mundësi, siç e gjykoj, që ata buburrecët, që gjallojnë nëpër gropat plehrash të jenë shumë më të lumtur se unë dhë kjo sepse atyre u mungojnë që të dyja, dua të them edhe kujtesa, edhe fantazia. Jo vetëm kaq, por plehurinat ku ata lëvrijinë pareshtur u japid, ndofta, kënaqësira të parrëfyera. Le që nuk ka ndonjë ndryshim të madh midis strofës së vjetër, që është shtëpia ime, dhe folesë së buburrecëve. Dhe është kulmi i pa-

1) Fjala është për mbretin Faruk (1936-1952) dhe presidentët e Republikës së Egjiptit (duke filluar nga viti 1953) M. Nagip, G. A. Naser, A. Sadat, M. H. Mubarak.

drejtësisë, që unë nuk munda ta pres këtë ditë në një mjedis festiv, në një shtëpi të pastër, ku çdo gjë të jetë në rregull, siç e do lezeti. Por nuk bëhem dot, jo, përsëri, ajo pemë luleplotë dhe frutëdhënëse, që kam qenë dikur. Sjellë ndërmend familjen time dhe fytyrën ma ngërdhesh një tèrbim i tmerrshëm dhe një helm i zi. Veç tani ka ikur edhe koha e shpage-sës. Ka ikur, po, dhe s'kthehet më kurrë. Sikur s'më besohet që të kem banuar pikërisht në këtë dhomë qysh prej viteve të shkollës dhe gjer në moshën e pensionit. Në këtë dhomë, që pothuajse s'ka ndryshuar fare gjatë tërë kësaj kohe! Ja shtrati im prej druri. Sa i fortë e sa jetëgjatë paske qenë o krevati im! Vitet e shumta nuk e mposhtën dot, jo, forcën tënde dhe nuk i thyen dot, jo, ato eshtrat e tua! Orenditë e sotme nuk mund të mburren se janë po aq harbutërisht të qëndrueshme. Ja, aty dollapi një-kanatësh, as i madh dhe as i vogël, i lashtë e i lashtë sa s'thuhet, mbasë edhe para Noes, i mbuluar tejpërtëj me pasqyrë. Midis dy dritareve vjen një tryezë e vogël me ca këmbë që s'duan t'ja dinë dhe me një faqe të gërryer, të gërvishtur e të çarë, ku unë përgatisja dikur mësimet, sa kohë që shkoja në shkollën fillore, të mesme e mandej në universitet. Aty pranë edhe minderi, si objekt antikuarumi. Ja edhe qilimi persian, të cilin ma dhuruan me rastin e mbarimit të shkollës dhe që është i vetmi send që e ruan ende bukurinë e tij. Arkitektura moderne nuk njeh dhoma asisoj kaq të mëdha, as tavanë kaq të larta e as të tillë parket. Po edhe godina, tanimë, e ka mbushur gjithashtu kohën për të dalë në pension. Edhe rrugës Abu Hoda vetëm emri i ka mbetur nga tërë stolitë e dikurshme. O, ju, ndërtesa të mjera të shekullit të kaluar, që ruani e mbanë në skutat tuaja të errëta gjithë ato kujtime rinie! Përveç ca banorëve

të rinj, që rrëth vetes nuk mbjelin tjetër përveç ftohtësisë, armiqësisë dhe frikës, asnjë fytyrë të re nuk më shohin sytë. Në tërë këtë goxha apartament të madh prej katër dhomash dhe një salloni unë sillem vetëm filli. Jo, harrova, brenda këtyre mureve reshپerojnë edhe brumbuj, edhe minjë. Fare më kot luftoj unë me këta mysafirë të paftuar, ashtu siç dua të zboj vetminë dhe brengën që s'më ndahet dhe tërë ato kujtime të ëmbla, ndërkohë që mallkoj kujtesën dhe fantazinë time. Tek rregulloj dhomën dhe ujdis shtratin, nuk mund të mos mendoj se njëherë e një kohë kam qenë qendër vëmëndjeje dhe shpresash të mëdha për një familje të tërë, që u shua me térésej. Unë kam qenë si ajo flaka qark së cilës rroisin plot flutura të bukura shumë. Betohem për Allahun, se bota e tërë s'kishte parë krijesa më të hijshme, më të brishta e më térheqëse sesa ato! Endërrat e mia qenë modeste, ashtu siç mund të jenë ato të një djaloshi të rëndomtë. Unë s'doja gjë tjetër, veç të martohesha e ta çoja jetën i qetë në gjirin e familjes e mes një vatre fëmijësh. Asnjëherë s'kam qenë unë si ca kolegë e miq të mi, që shpirtin ua ndrydhte një ambicje e tepruar. Disa syresh ia arritën qëllimit të dëshiruar, madje u bënë edhe të famshëm. Përse vallë m'u shëmbën shpresat dhe përse gjithçka më shkoi së prapthi? Përse mbeta unë ashtu, një pensionist qyq i vetëm që, përveç radios dhe televizorit dhe kujtimeve që më torturojnë, s'kam me kë të bisedojoj? Vazhdimisht e vazhdimisht u drejtohem dhe u them të afërmëve të mi: «Po të mos kishit qenë ju, unë nuk do të isha ai që jam...». Dhe ata më përgjigjen: «Po të mos kishim pasur këtë fat që patëm, të gjithë nuk do të ishim ata që jemi». Ç'të bëj, të nxehem apo, përkundrazi, ta lë veten të pushtohem nga një ndje-

një keqardhjeje e mëshire? Fundja, më në fund, fajin ma ka fati dhe ai duhet nëmur.

2.

Aty nga mesdita, ashtu siç qeshë, i këputur nga vapa, u ngrita dhe mora rrugën e kafenesë. Vetëm të dilja e vetëm të mos rrilia në atë apartament të tmerrshëm, që më ishte bërë si burg. Asnjë nga të njohurit e dikurshëm s'më ka mbetur. Disa vdiqën e ata që janë ende gjallëjeta i ka hallakatur anekënd qytetit. Rruga që lidh buharinë Abu Hoda me kafenenë «Brothësia» në «Sheshin e Ushtrisë» ka marrë një pamje krejt moderne: me trotuare plakash guri, me një rrëke njerëzore që gumëzhin paprerë, me ulërima rrënqethëse, me makina gjithfarrë markash e me plot vrunduj tymi. Për atë bukurinë e qëmotshme, për atë qetësi paqendjellëse e gjithpërpërpirëse tani as që mund të bëhet fjalë. Hamada at-Tartushi po më priste po në atë vendin e përhershëm, ulur pas tryezës, në sheshin e vogël para kafenesë.

Ai kishte dalë në pension pesë vjet para meje. Të dy të moshuar e të dy të vëtmuar, ne u afroam dhe u miqësuam me njëri-tjetrin. Rrudhat që i brazdojnë fytyrën, ia tradhtojnë sakaq pleqërinë, por dhe tiparet e fytytës dhe zëri e tregojnë më të madh se çështë në të vërtetë. Kokën e ka të bardhë si dëbora, vetullat kaleshe i varen mbi qepallat e syve si tel i ndryshkur, kurse sytë i ngjajnë me dy zjarre të shuar. Por, në të njëjtën kohë, ai është njeri mjaft i shoqërueshëm dhe mjaft i këndshëm. E në thashë që është i vëtmuar, e kisha në kuptimin që është pa një mik e pa një shok. Veç ai ka atë që më mungon mua: familjen. Djemtë e tij, të cilëve

karriera u ka shkuar mbroth, punojnë që të dy sdi se në ç'ministri. Shtëpinë e ka në rrugën ash-Sharfa, ku ai banon vetëm me të shoqen.

Sa më pa, at Tartushi u shkru është një buzagaz të tejpërtejmë, aq sa iu zbulan dhe nullëzat e dhëmbëve të rënë. Nëpërdhëmbi:

— Mirësevjen dhe pleqëri të mbarë! U bëfsh edhe njëqind vjeç, ishalla!

— Është ca e trishtuaar kjo punë, — ia ktheva kryeulët.

— Ç'është e drejta, unë e kam ndier më fort se ty.

— Telashet e përditëshme t'i largojnë ndjenjat romantike.

Ai shkundi atë dorën e tij plot gdhë e nyje.

— Mirë e ke ti, xha Halim. Po pensioni, sidoqoftë, është më i vogël se rroga.

— Se mos rroga mua më dilte. Mos harro, se ata që mbahen me pension vetëm dy hapa i ndajnë nga viktimat e urisë në Etiopi.

Ai hohoriti mbyturazi, mandej ndërroi tonin e më propozoi:

— A e bëjmë një dorë tavllë?

— E pse jo, kur kohën e kemi me bollëk, — iu përgjigja, pa ndonjë frysëzim të veçantë.

— Ti tani gjithë hallin e ke te vëtmia.

— Ashtu, mor, ashtu është, por ja që puna në ministri ma vrah gjysmën e jetës.

— Dëgjoma një këshillë: mundohu të rrish sa më pak në shtëpi.

— Do të ishte gjysma e të keqes sikur vëtmia të më mundonte vetëm brenda caqeve të shtëpisë, po unë atë e kam, ja, edhe këtu, — thashë duke treguar zemrën më gishtin e dorës.

— Me sa po shoh, ti ende ëndërron të martohesh, — tha ai me një fije buzagazi.

— Po pse, tani nuk e bëkam dot këtë punë? — pyeta i trishtuar.

— Kjo punë, si çdo punë tjetër, është në dorë të Allahut, por a s'më thua, me barut si je, ke apo s'ke barut?

— O po të gjithë më thonë se ndër moshatarët e mi, jam më i forti, — ia pata aty pér aty. — Madje ngandonjëherë, më duket sikur jetën po e filloj nga e para e sikur tani s'jam veçse pesëmbëdhjetë vjeç djalë. Edhe ato që quhen sëmundje kronike, sikur më kanë harruar, vetëm rrufa më ngacmon më të rraillë. Asnjë dhëmbë s'më ka rënë, ndër dhëmballët, vetëm katër kam mbushur. Kurrënjëherë s'kam pasur nevojë pér syze, qoftë pér të parë larg e qoftë pér të lexuar, megjithëqë, s'ka pse të mos e them, këto vitet e fundit librat më janë mërzitur dhe dëshira pér të lexuar më është pakësuar. Por nuk po zgjatem, duke mburrur vehten, se mos më marrin mësysh. Dhe, që të zbulojmë rrafsh, jo se nuk u besoj ca shënjave... paçka se më quajnë njeri të kulturnuar.

— Po u martove, — vijoi Hamada at Tartushi, o-o sa do më bëhet zemra! Por edhe sikur të ndodhë e kundërtë, prapë mos u qederos, se fatit s'ke ç'i bën. Vetëm një gjë mbaje vath në vesh: të mos i zilep-sësh kurrë të martuarit, si puna ime. Madje unë do të thoja se ti je pér të patur zili dhe jo unë. Të betohem pér Allahun, se asgjë tjetër nuk të leqendis e nuk ta shkurton aq shumë jetën, sesa martesa dhe mësuesia në një shkollë të mesme!

Sa e sa herë m'i kishte thënë ai këto fjalë! Dhe po kaq herë ato fjalët e tij më hynin në njërin vesh e më dilnin, sakaq, në tjetrin. Është e vërtetë se s'më

kishte qëlluar t'i provoja kokëçarjet e tij. Veç duke qenë pa familje kam harruar të ngjëroj një gjellë të ngrohtë dhe shpirtin e mbaj gjallë veç me sanduiçë dhe konserva. Dhe përpos radios dhe televizorit, asnjë kënaqësi tjetër s'më ka ngelur. E prapëseprapë kurrë s'kam reshtur së ëndërruari për t'u bërë me bashkëshorte e me fëmijë. Madje edhe sot e kësaj dite. Njëfarë ngushullimi e gjej në lojën e tavllës. Gjithmonë jam si i pikëlluar, por kur detyrohem të kthehem në atë ndërtesen e vjetëruar në rrugën Abu Hoda, sepse më priten gjunjët dhe dridhem i téri. Me Hamada at Tartushin u bëra mik dhe një miku s'ke se si të mos ia hapësh zemrën e të mos i zbulosh mjaft nga të fshehtat e jetës sate. Pasi i rrëfeva, pra, edhe historinë e Meleqes, ai më pyeti:

- Po sa vjeç është ajo taní?
- Po ja e shumta, nja dy vjet më e vogël se unë.
- Po a ta mbush syrin, ashtu, si femër?
- Jo një herë e dy më ka rastisur ta shoh në ballkon, tek eci rrugës, për në kafene. Dhe ja... po ta them, ajo nuk është se ka mbaruar fare si femër...

Në këto e sipër, ai, mori një pamje serioze dhe tha:

— Është grua e ve, të dy djemtë i kanë vajtur në Arabinë Saudite dhe i kanë mbetur atje me banim të pérhershëm. Dhe tani rron fillikate ashtu sikundër dhe ti. Shkoi, pra, për një vizitë, sa për t'i matur pulsin. Se, mbi të gjitha, e ke dhe kushurirë.

Kur m'i tha këto fjalë, në fillim më erdhi për të qeshur. Mirëpo do t'i që, pas ca kohe, atje po atje më rrinte mendja. Dhe ç'punonte, sakaq kjo fantazia ime: më nxirrte parasysh lloj-lloj tablora! Më kish të ndodhur edhe më parë një gjë e tillë, sidomos atëherë kur epshi më mundonte pa mëshirë. Sa bija

për të fjetur, Meleqja më afrohej dhe ne fillonim muhabetin, duke gjërgarë njeri-tjetrin, veç kjo ishte ajo vasha e dikurshme, ajo vasha e ëndërrave dhe e zemrës sime, të cilën natyra e kishte ruajtur enkas për të qenë gruaja ime. Ah, sa keq që kjo ishte vetëm një ëndërr dhe asgjë më tepër! Nuk ishte fjala këtu për një dashuri të jashtëzakonshme, së cilës vitet nuk i bëjnë dot gjë. Dashuri s'kishte më, ajo kishte vdekur. Unë isha në dasmën e Meleqes dhe ungopa me sehir, tamam si të isha një i huaj. Po a s'më thoni, si ta mposht vetminë e si ta shuaj unë urinë e këtij epshi të shfrenuar? Mallkoj e mallkoj prapësitë e fatit mizor që u derdhën mbi vendin tim dhe mbi tërë botën si dhe mbi mua dhe tërë shtëpi-në, mallkoj vendin ku më ra koka, mes rrugës «Ali Hoda» dhe «Sheshit të Ushtrisë». A ka pasur ndonjë tjetër, vallë, si puna ime që të ketë lindur, të jetë rritur dhe plakur po në të njëjtën lagje, po në të njëjtën rrugë, po në të njëtin apartament dhe po në të njëtin dhomë? A ka pasur vallë ndonjë tjetër në dynja, veç meje, që sa herë është orvatur të ndërroj vendbanimin, rrethanat nuk e kanë lënë po i janë vërsulur dhe e kanë zënë prej gryke? Më hipën gjak-u në kokë dhe bëhem si i xhindosur sa herë i avitem, në çdo orë të ditës e të natës, asaj binaje të lashtë, për të ngjitur ato shkallë plot pisllëqe, me ca basamakë të shtrembëuar, që për shkak të papastërtisë, nuk ua merr dot vesh se c'ngjyrë kanë pasur, kur janë ndërtuar. Shtëpia është pa portier e pa pastrues. E unë nuk e duroj dot papastërtinë dhe nuk e honeps dot rrëmujën. Fyejt e hundës m'i godet një duhmë e rëndë myku, veç, pas gjithë këtyre të këqijave, vetëkuptohet, se qëndron inflacioni, politika e dyerve të hapura», luftërat dhe anomalitë e ekonomisë botërore. Unë, për veten time, vetëm një

dëshirë kam pasur — të martohesha me Meleqen, të bijën e kushuririt tim, Baha efendi-Osmanit.

3.

Një ditë prej ditësh, Hamada at Tartushi më tha:

— Nuk ma ha mendja që vendi ynë ta kaloj kaq lehtë këtë krizë.

— Do bëje mirë të merakosesha për krizën që na ka mbërthyer ne të dy! — e kundërshtova me inat.

— Mos harro se vitet ne i kemi të numëruara, ndërsa vendi mund të rrojë dhe me shekuj.

At Tartushit i pëlqejnë muhabetet rrëth temave abstrakte, mirépo unë s'ia kam ngenë, se kam hällët e mia. Kundroj banesën time të shpëlarë dhe pa dashur më lind pyetja: «A është e mundur, vallë, që kjo karakatinë të ketë qenë, dikur, djep rehatie familjare, dashurie dhe ndjenjash fisnikë? Mbas Fiqiries dhe Zejnabit, nëna lindi gjashtë djem me radhë, njërin pas tjetrit, por këta i vdiqën të tërë, pa dalë ende nga shpërngënjtë. Në fund fare më nxori edhe mua në dritën e diellit, mua që i mbusha prindërit e mi me besim e bindje se edhe ata nuk binin më posht se nënët dhe baballarët e tjerë. Esh-të pikërisht kjo arsyëja, që unë u bëra një lodër e dashur jo vetëm për nënën dhe babanë, por për tërë familjen. A mund ta harroj unë atë dhimburi që shprehnin Fiqiria dhe Zejnabi ndaj meje? Kur më merte babai me vete në kafene, për të më gjëzuar me gjësend, të gjithë bëheshin copë, për të më veshur sa më mirë. Nëna më krihte flokët, Fiqiria më binte kostumin e marinarit, Zejnabi më lustronte, gjer në shkëlqim, këpucët. Babai dilte nga dhoma me një petk të modës së fundit dhe kundërmonte i téri parfum i mermë. Pa e hequr nga dora bastunin

me dorezë fildishi, ai më hidhte një vështrim miratues përmes syzeve me skelet ari dhe më thoshte buzëqeshur:

— Urdhëroni, Halim bek!¹⁾

Babanë tim e quanin Abad al-Kavi al-Bek. Në këtë rast fjala «bek» është thjesht një emër, por ai mua ma shtonte si titull nderi, paçka se im gjysh s'kish qenë veçse një pastiqier i rëndomtë në rrugën ash-Sheih Komar: në kafene babai porosiste për mua akullore dhe më mburte para miqve të tij, duke thënë se isha një fëmijë me zhvillim të parakohshëm. Në këtë e sipër, nuk harronte të kreñohej:

— Në një fotografi që kam në shtëpi, djali më shëmbëllen si dy pikë uji me Saad Zagnullën²⁾, kur ka qenë i vogël.

Unë kam ca sy të fortë, që dinë të vështrojnë më thellë nga çmund të pandehë njeri apo tjetri. Po, po, këtë e di mirë. Ja, tek jemi mbledhur rrëth tryezës së drekës, gjithë familja. Sadoqë i dua të tërë, veç kjo s'më pengon, ama, që t'u vë re dhe t'u nxjerrë në pah edhe cenet më të imëta. Ja, fjala vjen, fytyra e tim eti s'më pëlqen hiç, sidomos kur është pa syze. Një fytyrë e hequr, e thatë, e stërgjatur, disi si e plloqtë, me një hundë kaq të vockël, sa të vinte për të qeshur kur e shihje, e me një palë sy të ngushta, si ca të prera sëpate dhe me një ballë të da-

1) Bek ose bej (turqisht) — më parë titull parie në vendet e Lindjes së Aférme.

2) Saad Zagnull (1857-1927) — Personalitet shtetëror dhe politik egjyptian, themelues dhe udhëheqës i partisë liberale nacionaliste «Vafdi» që kryesoi pas Luftës së Parë Botërore përpjekjet e Egjiptit për pavarësi.

lä — shkurt llafi, me një pamje aspak për t'u lavdëruar. Kurse nëna vinte shtatëhedhur, me një fytërë nazike, me ca sy të bukur e të mëdhenj, me ca flokë të butë e valë-valë dhe me atë hundën e drejtë dhe të hollë. Ç'është e drejta, zëri i saj ishte ca si hundak dhe përherë ajo fliste me një ton të pakë-naqur dhe histerik. Ja, vetëm këto dy gjëra nuk i shkonin dhe nuk e zbuluronin nënën time. Por më tepër nga të gjithë i eci ters Fiqires dhe Zejnabit, të cilat një ditë erdhën dhe u bënë një kopje e dytë e babait. Nga nëna unë trashëgova fytyrën e saj të lezetshme, çka nuk ia pashë një herë hairin. Ndaj, pra, nuk është e rastit, ajo, që shtëpisë sonë iu mblo-dhën kaq e kaq prapësira. Dhe të vetmit, që i buzë-qeshi disi fati isha unë, por kjo s'do të thotë, ama, që punët më vajtën kurdoherë dyst. Tërë sjellja dhe tërë fjalët e nënës tradhtonin qartë njëfarë nervozizmi dhe të ardhmen ajo e përfytyronte ngahera me ngjyra të errëta. Ankthi i rritej gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës. Rrinte rrinte dhe i thoshte të shoqit:

— Duhej t'i kishim dërguar vajzatën shkollë.

Ai i përgjigjet:

— Allahu le të më gjykojë, por unë s'mund ta ulja kaq poshtë veten time.

Prindërit e mi kishin një harmoni shembullore mes tyre, edhe babai merrej vesh për mrekulli si me Fiqiren ashtu edhe me Zejnabin. Vetëm nëna shkonte me të dyja të bijat, pothuajse, si macja me minun. Që të trejave sikur u kishte hyrë lepuri në bark, ndaj i shikoje vazhdimi shëndetësor, të tendosura, të acaruar, me një armiqësi pa shkak. Qenë ca zenka këto që s'kishin kurrë të sosur, ca të shara të ndyra, që s'kishin kurrë të mbaruar.

Ali Jusufi, miku dhe komshiu im i tanishëm si

dhe bashkënxënësi im i dikurshëm, një herë u hodh e më tha me një bindje të plotë:

— S'ka gjë më të madhe se sa të jesh djalë i një babai të pasur.

E pashë me habi dhe e pyeta:

— Pse ma thua këtë?

— Sepse një fshat që duket s'ka nevojë për kallauz. Në tërë rrugën tonë ai është njeriu më me peshë.

Nuk e kundërshtova, veç, sakaj, e përqasa me mëndje babanë me Jusuf-efendinë, të atin e shokut tim. Ali Jusufi vijoi:

— Por as'më thua, or babush, sa para xhepi të japidit në ditë?

Po, moshatarët e mi i merrnin a s'i merrnin gjysëm piastre në ditë, kurse unë kapërdisesha me plot një piastër në kuletë.

Hera-herës babai më shpinte edhe në kinema, edhe në kafene. Aliu, shoku im, më thoshte se unë hyja në sërën e familjeve «fisnike». Asohere shtëpia jonë ishte ende në moshën e rinisë, pra, më e re se shtëpia e Ali Jusufit dhe e Baba Osmanit, i ati i Meleqes. Për atë zot, mua më vinte mirë që më radhisnin në vargun e djemëve të pasur e të sojmë, se, a s'më thoni a ka gjë më të bukur në këtë botë, sesa pasuria? Kur e kur këtë gjëzim ia derdhja edhe nënës.

— Ne a jemi të pasur nënë?

Dhe ajo më përgjigjej me zërin e saj hundak (e kjo ndoshta ishte e vëtmja gjë që ia prishte bukurinë):

— I qofshim fal Allahut, asgjë s'na mungon.

— Po çiflik a kemi?

— Jo, bir i nënës, çiflik s'kemi — buzëqeshte ajo.

— Po nga e gjeti, atëhere, babai tërë këtë pasuri?

— E po bujaria e Allahut s'ka anë e fund, mor bir.

Me ç'duket, të pasurit nuk ua rrëfejnë fëmijëve, gjer në një farë moshe, burimet e pasurisë së tyre. Gjithsesi, ne mund të hanim ç'të donim; gjatë muajit të ramazanit sepeta na mbushej me arra, përbajram të vogël me ëmbëlsira lloj-lloj, kurse përbajramin e madh, mbi këto të gjitha, që edhe mishi i dashit.

Pra, mua më qe fiksuar se ridhja nga një familje e pasur. Midis të tjerash, babai kishte edhe një meritë: ishte i vetmi në familjen tonë që lexonte një gazetë të përditëshme dhe një të përvjavëshme të ilustruar. Edhe mua pasionin e të lexuarit babai ma mëkoi. Pasi m'u gërdit një revistë fëmijësh, iu luta të më blinte një vëllim me novela të përkthyera. Ish-te pikërisht ky libër që më ndryshoi tërë rjedhën e jetës. Paskëtaj, unë jetoja në dy botë njëherësh: edhe në botën e realitetit të përditshëm, me shkollën dhe grindjet e paprera të grave në shtëpi, edhe me botën e fantazisë, mbushur me heronj dhe heroina romanesh.

Babai më pyeste:

— Shiko se mos të pengojnë në mësime librat që lexon!

— Jo baba, mos ki merak, se në mësime unë jam përmby shokët.

— Se ti duhet të mbarosh patjetër një shkollë të lartë e të diplomohesh — më frymëzonte ai.

— Po ja, ti pa diplomë je, apo jo?

— E, në kohën tonë hante qeni petulla. Atëhere shkolla fillore vlerësohej njësoj si universiteti tanë, — më sqaronte ai, gjithë, me të qeshur. — Veç kije

párasys h se unë mora edhe një zanat. Mandej, tani, edhe mundësítë janë më të mëdha. Po ti ç'do të dë-shiroje të bëheshe?

— Ja, të isha kështu si ti.

— Në ç'kuptim?

— Po ja, të kisha një kostum si tëndin, të isha po kaq i pasur sa dhe ti, sigurisht, të kisha dhe një shtëpi.

Ai gjajasej së qeshuri.

— Mirë, mirë rritu dhe ca se do të vijë dita që do t'i përgjigjesh edhe kësaj pyetjeje.

4.

Nën shembullin e babait unë edhe lutesha, edhe agjëroja, si tërë burrat. Kurse gratë veëm agjëronin. Babai ishte shpirt njeriu, i dashur e gazmor, që s'mund ta kuptonte jetën pa shakara. Ama kur i hipnin kacabujtë mbyllej në dhomë ose vishte në çast kostumin dhe fësht, ia mbathe për në kafene.

Ajo jetë iku njëherë e përgjithmonë, së bashku me heronjtë e saj, që u zhdukën nga skena, për të mos u kthyer më kurrë. Ata tani po bëjnë gjumin e amëshuar në varrezat Bab an Nasar, brenda atij varri të madh me mure të trasha guri, gjysma e të cilit është caktuar për gratë dhe gjysma tjetër për burrat.

Unë ditët i lëbyr po në atë dhomë, që kam banuar tërë kohën, puq me odën e tim eti, e cila ende është në gjëndje deti diku të mirë. Në shtëpi s'më presin vëç radioja, televizori dhe librat. Ja dhe salloni i pritjes, me tryezën e bukës e katër karrigjet dhe me raftin gjysëm të zbrazur. Mobiljet e vjetra u shitën me të lirë, kurse dy dhomat e tjera, përveç katër mureve, asgjë tjetër nuk kanë. Unë s'kam

kuzhinë, në kuptimin që i japid njerëzit kësaj fjalë. Vetëm një furnelë gazi, që më shërben për të zjerë çajin ose kafenë. Ushqehem me bath, tamija,¹⁾ konserva, ngandonjëherë edhe me vezë. Me fjalë të tjera, siç e shikoni, unë ha po ato që hanë edhe filozofët në këtë kohën tonë të çmëndur.

Vetmia më lodh e më sfilit, ndaj edhe unë përpigjem ta luftoj atë sa më vendosmërisht: duke hapur televizorin dhe duke dalë kafeneve. Tani edhe për të lexuar, lexoj shumë rrallë. Vanë ato kohëra kur bashkëudhëtarët e jetës sime qenë titanët e mendimit kombëtar dhe korifejt e letërsisë së huaj. Falë tyre unë thellova njohuritë e mia kulturore, u bëra më i ditur, veç të gjitha këto nuk ndikuani asfare në bindjet e mia ose, më saktë, nuk ndikuani në atë masë, sa unë të hiqja dorë prej tyre. Mbasi edhe sot e kësaj dite vazhdoj të lutem dhe të mbaj ramazan si më parë, gjithë, duke pritur fundim tim të pashmangshëm. Eh, si do iki kështu nga kjo jetë, pa lënë një gjurmë e pa bërë diçka, në mënyrë që të meritoja, sadopak, respektin e njerëzisë. E ndiej veten aq shumë të trishtuar dhe aq shumë të mërzitur, sa edhe shtëpia më është vështirosur, aq sa më dhëmbin sytë kur e shikoj. Ditët i ngrys dhe i gdhij me frikën e sëmundjes dhe të vdekjes, që më ndjek këmba-këmbës. Llahtarise kur mendoj se mos më vë posht lëngata dhe s'do të kem pranë njeri që të më japë goftë edhe një gotë ujë ose se mos vdes, pa pritur e pa kujtuar, dhe qelb dynjanë duke mbetur pa varrosur. Në çastet e kthjellimit porosis vetveten: «Shporri, shporri këto mendime, se është gjynah t'i

1) Tamija – gjellë me bathë të grira, që gatuhet me gjalp, qëpë e hudhra, si edhe me erëza me jave, mendër.

52855

veshë shpirtit merak gjer pa ndodhur ajo ç'ka për të ndodhur».

At Tartushi, pra, mendon se une qenkam për t'u pasur zili! Hë, qerratai, gjeti kë të bëjë sylesh! Djemtë i notojnë në luks e në bollëk dhe në krye të çdo muaji e ndihmojnë me të holla. Kur t'i vijë so-sja, shtëpia do t'i mbushet dinga me njerëz dhe tërë al-Abisija do të gjëmojë nga ulurimat e vajit. Gaze-ta «Al-Ahram»¹⁾ do t'i kushtojë një nekrologji me këtë tiradë: «Kthehu te zoti yt o shpirti i atij që ndërroi jetë, se atje do të qetohesh e do të lumturo-hesh. Iku e na la nën mëshirën e Allahut o mësuesi ynë i nderuar». Mbas arkivolit do të çapitet vargani i njerëzve të nderuar — miqtë e djemve dhe një mori të afërmish të tjerë. Këtij njeriu krejt pa vlerë, ndonëse jo të keq, do t'i bëjnë, pra, një varrim madhështor.

Kurse po tundi këmbën Halim beu, as që mund të bëhet fjalë për ndonjë nekrologji. Vetëm një njof-tim i thjeshtë në rubrikën e lajmërimeve, se ndërroi jetë filan fistëku. Asgjë më tepër. Ja, pra, kush jam unë, o Hamada at Tartushi dhe më ki zili, tani, po ta mbajti. Se ti nuk e di ç'është vëtmia, se ti nuk e njeh erën e mykut në banesën tënde, se, ndonëse pa një dhëmbë në gojë, ti ha për ditë mish. Ti nuk e di se ç'është shtrati i ftohtë, i pangrohur kurrë prej zjarrit bashkëshortor dhe ti nuk e imagjinon dot vëten pa ledhatimet e gruas dhe pa afshin e ndjenjave atërore. Po të kisha pasur të tjerë mia do të të kisha bërë def prej kohësh o Hamada^{1a)} — folëmnderit televizorit! Atë, po, e kam tamam mik për kokë, se

1) «Al-Ahram» («Piramidat») — gazeta më e vjetër e Egjyp-tit, botohet që nga viti 1875.

ai më merr e më fut në botën e fantazisë dhe të fe-
mrave të bukura...

O ti jetë e mjerë, o ti jetë e kotë! Por nuk është se unë jam një qenie krejt pa mend në kokë dhe kreit e papërfillshme. Gjer dje isha një goxha inspektor në Ministrinë e Kulturës. Endrrat edhe mund t'i kisha përbushur, po të mos më kishin penguar disa rrethana. E ç'dobi mund të sjellë një ngri- tie simbolike e rrogës, nëse çmimet shtrenjtohen katërfish për shkak të inflacionit? Për tërë kusuret fajin s'ma ka vetëm familja, por bota e tërë, me ekonominë dhe politikën e saj të mbapshtë. Sa u përpooa t'i qëndroja sa më larg kësaj bote, por ajo s'deshi aë s'deshi të më linte rehat në halin tim.

Ku ta gjei një hidraulik që të më rregulloj rubinetin e çezmës së banjës? Interesant, sa do të më kërkojë ai, vallë, për një shërbim kaq të thjeshtë? Do të isha i lumtur sikur gjivsmën e kohës ta kaloja në gjumë, po ja që s'mund të dremis më tepër se pësë orë në ditë. Ma more shpirtin, duke menduar përtty, ditë e natë, o Meleqe, ndaj do ta kisha shumë të nevoishme të pushoja ca kohë larg teje. O Meleqe, unë edhe tani me mendtë e mia llafosem orë e cast me ty! Nië parandjenië më cyt e më thotë se ti je nra ato lloji grash që ende mund të bëshë dashuri. Të dy kemi mbetur avq, o Meleqe! Përse të mos e bëjmë tani atë, që fati nuk na la ta bënim më parë? At Tortushi më ofroi idenë të vij e të të takoj e tani umë i giori i am shndërruar i téri në një viktimë të kësaj ideje fikse. Imagiinata nisi të mos punojë ethshëm. Ja, unë shtyp butonin e ziles dhe pres, pres. Mbas pak sythi i derës çelet dhe ti më kundron e më thua: «Ah, kush na qenka... Pa urdhëro, të lutem, urdhëro. Po ç'bëri vaki, që na kujtovë, ashtu, krejt papandehur?» »Po ja, po kaloja këtej

pari». «Urdhëro». Biseda sillet nga dega në degë e, sado që mundohm ta luaj rolin sa më mirë, prapë sytë nuk i shkëpus e nuk i shkëpus dot nga gjoksi i saj. Ajo m'i pikas mendimet dhe ma bënë lehtë me shenjë që t'i ulem pranë, si dikur. Kundërshtimet e saj të prera s'bëjnë tjetër veçse ma shtojnë akoma më tepër oreksin, gjersa më në fund përqafohemi dhe shtërnghohemi e ngjishemi pas njeri-tjetrit, dhe ja malli i tmerrshëm, që mend na mbyti për pak, u shua dhe s'qe më...

Ah, sikur këto èndërrat e mia të genë vërtetuar, o Meleqe. Rrugëve të mëhallës unë takohesha dhe me gra të tjera. Syresh çlirohej aroma delikate e një të kaluare të bukur. Me to koha èshtë treguar e pamëshirëshme, i ka ndryshuar kaq shumë saqë mezijnihen dhe nga e kaluara s'u kanë mbetur tjetër veçse emrat. Kur përballemi dhe i dhurojmë njeri-tjetrit ca buzëqeshje fluturake, unë sérish e ndjejë se, tanimë, ato më janë bërë krejt të huaja. Ato sot janë bërë nëna dhe kryefamiljare të nderuara. Po të mos kisha natyr ato kushte që zura ngoje më sipër, ndonjérën do ta kisha përlarë dhe do ta kisha bërë gruan time. Por të gjitha këto arsyetime tani janë si kofini pas të vjelit.

Në këtë moshë unë lahem dhe ndërrohem një herë në iavë, për të kursyer sa më tepër, për të nxjerrë dhjam nga pleshti, si i thonë fjalës. Edhe shishqebatin vetëm në ndonjë rast të veçantë e vë në gojë. Pensionistët, nierëzit nuk i kanë më në listën e të gjallëve. Dikur fluturoja si shqiponja në krahët e rinisë sime që gjithë lulëzonte. Vinin në shtëpi shoqet e nënës dhe e bënë gojën corape duke deklaruar: «Halimi i nërshtatet edhe Meleqes, edhe Buseinës, edhe Rebabit, edhe Bisës». Mirëpo nënën e brente meraku i të bijave, fati tragjik i tyre. Me ka-

limin e viteve shpresat për t'i parë ato të martuara sa vinin gjithë fikeshin e fikeshin. Të gjithave u kishte dal fati veç Fiqiries dhe Zejnabit. Asnjë i afërt ose i largët s'po na trokiste në derë. Çuditesha dhe pyesja veten: «Sa e sa gra të shëmtuara ka në këtë dynja! A s'mjaftoka tërë pasuria e babait për të shëruar këtë plagë?»

Krejt i çliruar nga barra e telasheve familjare, unë vahzdoja gjithë krenari fluturimin mbi flatrat e rinisë. Në shtëpinë, tonë vinin, me lloj-lloj sebebesh, Meleqja, Buseina, Rebabi dhe Birsa, të shoqëruara nga nënët e tyre, njëra më e bukur se tjetra dhe të gjitha yll të bukura. Në atmosferën e zymtë të shtëpisë sonë shpërthenin flakërima ngashnjimi dhe koketerie; kryqëzoheshin vështrime plot pasion dhe dëshirë dhe s'ndodhje kurrë që të mos shqiptohej, si padashur, ndonjë fjalë e ëmbël apo që të mos përqalleshim qoftë edhe lehtazi mes nesh apo që të mos shkëmbenim madje edhe ndonjë të puthur, të cilën ua vidhним vështrimit të grave. Unë i doja të gjitha, veg tek asnjera nuk përqëndrohesha. Në praninë e njërsë e harroja përkohësisht tjetrën, por Meleqja qysh atëhere shquhej përmbi shoqet për mënçurinë dhe karakterin e saj. S'më ndërmendet në isha student apo nxënës i shkollës së mesme, kur nëna m'u afrua dhe më pyeti:

— Cila të pëlqen më tepër?

U përtypa një grimë herë e shqiptova:

— Nuk e di!

— E po edhe gishtrinjtë e dorës nuk janë njësoj, të shkretën.

M'u përshkua nëpër mend Meleqja, por zëmrën nuk ia hapa:

— Të gjitha ngjajnë me shoqja shoqen.

Ajo shpuri buzën në gaz e tha:

— Ah, të të shihja një ditë ty me fëmijë e pastaj s'do më vinte keg të vdisja. Nuk e kam humbur shpresën tek Allahu që do m'i ndihmojë Fiqirien dhe Zejnabin, që të të vij dhe ty radha, mandej.

Asohëre unë bëja një jetë pak a shumë të qetë. Më të rallë më trazonte ndonjë ngjarje e vogël. Me Buseinën u ndodha një ditë në Abisinë Lindore dhe u puthëm shpejt e shpejt, që të mos na shikonte njëri. Me Rebabin këmbenim dhuratëza simbolike, Bisa më jepte letrat e saj në dorë me fshehtësinë më të madhe, kurse me Meleqen ç'kishim për të thënë ia thoshim njeri-tjetrit me anën e vështrimeve. Dehesha nga gëzimi kur shihja rolin që luaja, atë të një dielli, rrëth të cilit vajzat vinin rrotull si planete. Ah, sikur t'i mblidhja ato të gjitha së bashku në një harem! Por Meleqja pak e nga pak e një çikë e nga një çikë po ma hante zemrën, e në këtë e sipër, para këtij dielli që po shpërthente dritëzat e yjeve të tjerë gjithë zbeheshin e zbreheshin. Edhe sot e kësaj dite s'më hiqet nga sytë ajo ninëzë: tramvaji ecte ngadalë nepër Abisi dhe në vagonin e grave Meleqja si një statuje mermeri, shtatlartë, e plotë, por me masë, me ca gjinjë të kërcyer, me atë cipën e lëkurës që i ndriste, me flökët e bollshëm të zinjë pis dhe me ca sy hyjnorë.

Ajo kishte mbaruar shkollën e mesme dhe ekonominë shtëpijake e njihte mirë. Prindërit tanë kishim hyrje-dalje, shtroheshin në muhabete të gjata e të ciltra. Edhe unë, nga ana ime, i veja shpesh në shtëpi, ndaj dhe fejesën tonë njerëzia e kish bërë fakt të kryer. Nga ky shkak edhe lajmësit e tjerë nuk i binin më në qafë Meleqes. Motrat e saj qenë martuar, kurse ajo më priste mua. Mua që do të bëhesha burri, i saj dhe ajo — gruaja ime! Edhe pasi mbarova studimet dhe fillova nga puna, ëndërra për

tu martuar me Meleqen mbeti dëshira ime më e zjarrtë. Sa e sa raste mbetëm të dy vetëm në shtëpinë e saj. Kur ajo m'i qepte sytë plot pasion e ledhati, më ngjante vetja si ai çajniku mbi furnelë, kapaku i të cilët fërgëllon e çohet nga avulli që zien brenda tij. Në edhe putheshim, por ajo s'më linte ta teproja dhe më pëshpëriste me të butë:

— Çdo gjë ka një cak.

Ndërsa unë ngulmoja në timen, ajo lidhëtë vështrimin kah e ardhmja dhe më çelte zemrën:

— Mos u bezdis, çdo gjë ka kohën e vet, vetëm vregullohu një herë në punë dhe vërë mënjanë nja njëqind ginei.

— Im atë përmua djeg edhe shtëpinë, — i përgjigjesha me mëndjemadhësi.

— Yt at është një nëpunës, siç ka qenë edhe imi.

Tërë rruga ziente për dashurinë tonë. Ajo i mbushte me krenari zemrat e prindërve të mi, kurse shoku im, Ali Jusufi, i-shikonte me skepticizëm marrëdhëni e mia me Meleqen. Po të mos kishte qenë tragjedia e Fiqires dhe e Zejnabit, prindërit e mi do të kishin zënë qiellin me dorë nga lumturia dhe s'do të pezmatoheshin kurrë, siç pezmatoheshin tani — babai më të rrallë, nëna — ore e çast.

Por mua dashuria nuk më mjafkonte, mua zoti më kishte stisur për një jetë të virtytshme. Për një jetë të virtytshme dhe familjare.

5.

Sot luajta tavëll me Hamada at Tartushin me një kusht që ai që do të mundej, do të paguante filxhanin e kafesë. Por gjëzimin e kësaj fitoreje nuk arrita ta shijoja gjer në fund. Rrinim të dy bashkë

dhe sodisnim «Sheshin e Ushtrisë», përmbytur nga një mori dritash të forta. Një shesh plot me burra, gra dhe fëmijë! Dhe që rrihej nga lloj-lloj mjetesh transporti, duke filluar nga karrot e talikat e gjer tek autobuzët e tramvajet, të cilët pasqyronin, si në një vitrinë, historinë e gjallë të civilizimit. Rrinim e dëgjonim gjithfarë zhurma — biseda, sharje, britma e këngë. Hamada ngau bisedën:

— Ky vend...

Ai qahet dhe shfryr kundër tërë botës dhe i vjen plasje që unë nuk e prish terezinë.

— Si, asgjë nuk të shqetëson?

— Jam velur deri në grykë me këto shqetësimë.

— Po ti ke një jetë të pasur, ke njojur gjithë ata njerëz, madje dhe luftëra të kanë parë sytë.

— E çë pastaj?

— Tì vetëm hallin tënd shikon.

— Po, se edhe hallet e mia janë më të mëdha sesa ato të vendit.

— Po mos harro se je intelektual!

— Ik or dreq!

Hamada shkrihet së qeshuri — ai ende di të qeshë me gjithë shpirt — dhe thotë:

— Do të ishte feja vetë sikur ta filloje jetën nga e para.

— Ç'do të thuash me këtë?

— Po ti anglishten e zoteron, se ke ndjekur kurset e mbrëmjes për administratorë dhe sekretarë në kohën e «infitah-hës». ¹⁾ Kështu që nuk e ke të vësh-tirë të fillosh gjékundi në ndonjë punë.

1) Infitah (arab) — liberalizëm; është fjala për politikën e «dyerve të hapura», që ndoqi presidenti Sadat në vitet 70' kur Egjipti i hapi rrugën gjërësisht kapitalit të huaj.

— Jam lodhur.

— Shiko, se po ndënje një kohë të gjatë duar-kryq, ka rrezik të të mbysë myku i dembelizmit.

— Mos e prish gjakun për mua.

Tani vende pune ka boll dhe me ç'kam dëgju:ar nuk paguajnë keq, vetëkuptohet, se jo në atë masë sa që unë të përmirësojë sado pak jetesën time. Vëtëm se mund t'i shtoj vetes ndonjë gjellë të ngrohtë, se për të siguruar ndonjë apartament të ri, në një nga ato blloqet moderne të shtëpive, as që guxoj ta mendoj.

I them Hamadës:

— Bëj durim, se së shpejti ke për të dëgjuar një sihariq të këndshëm.

Ai zbardh dhëmbët.

— Të duhet ta mbash lart flamurin e pensionistëve!

— E ç'përfitim pata nga shëndeti që e kam grurë? Prapë vuaj e heq e prapë vëtmia po më sfilit, ndaj Allahut, që i di të gjitha, do t'i lutem e do t'i përgjërohem të vërë dorën në zemër dhe të më ndihmojë.

— Sikur të kisha qenë pak më shumë besimtar, ndofta do të isha më i lumtur.

— Njeriu o beson, o s'beson, rruga të mesme s'ka.

Ia kthej me zemërim:

— Sot sepse qënke brîsk nga goja.

Ai mezi e mban gazin:

— Unë s'kam besim tek inteligjencia!

Heshta. Një minutë nuk i pushon goja, veç netëve gjumin e bënë për shtatë palë qejfe. Por ai është i gjithi sa më ka mbetur në këtë kohë të çmëndur. Po ku jeni ju, o shokët e mi? Po ju, o miqtë e mi të ngushtë, ç'u bëtë vallë?

6.

S'më ndërmendet se kush kishte ardhur: e ëma e Rebabit apo e Buseinës, vetëm dëgjova zërin e nënës që tha:

— Halimi s'mund të fejohet pa mbaruar shkollën.

Një logjikë e hekurt që më tërbon. Por shqyr që s'është e ëma e Meleqes, e cila para ca ditësh më kishte pyetur:

— Kur do ta shpalni fejesën?

— Rrethanat familjare nuk më lejojnë ta bëj një gjë të tillë, pa mbaruar studimet!

Ajo lëshoi pe. E bëri zemrën gur dhe e pa të arsyeshme të mos ngulmonte. Dhe, ndërkohë, që unë vazhdoja studimet në universitet, u martuan me radhë edhe Buseina, edhe Rebabi, edhe Bisa. Dhe sa herë që ndonjë nga këto vajaz më linte shëndënë, sepse ndieja një dhëmbkë në shpirt që ma kalonte shpejt, ç'është e vërteta, pa më lënë ndonjë mbresë të thellë. Martesa qenka më e fortë se dashuria. Hamngjitjet e martesës, duke qenë jetëgjata, të nga shnjejnë edhe më tepër. Endrrat rozë të rinisë davariten shpejt e shpejt, si ajo aromë parfumesh e një gruaje që nxiton pranë teje. Deri në frysëma rrjen e fundit s'kam për t'i harruar ato fjalë që më tha Meleqja në një çast dëlirësie:

— Edhe sikur një princ të më kërkonte, s'do të pranoja, se në këtë botë përvëç teje nuk ekziston njeri tjetër për mua.

Meleqja më dukej një grua besnikë dhe së cilës mund t'i besohej, më besnikë dhe më e vërtetë se çdo e vërtetë tjetër në këtë botë. Ah, po ajo qe një dashuri e madhe, po ajo qe një dashuri e thellë, që

triumfoi asaj dite tē lumtur, që pér mua mbeti e pa-harruar.

Nga dritrja e dhomës së vet, Meleqja më kishte parë tek i bëja ca isharete Buseinës. Qysh në vizitën e parë që bëri pas kësaj, në shtëpinë time me tē emën, më hyri vrulltazi në dhomë e më pyeti si me druajtje:

— A pranon urime?

Mbeta pa mend.

— Me ç'rast?

— E po, pér Buseinën, de.

Sikur më ra tavani mbi krye. Një valë herë tē gjatë nuk ia ndava vështrimin. Edhe ajo, guximtarë, m'i nguli sytë. Xhelozia nuk e linte ta shprehte hapur dashurinë. O zot, sa e bukur ishte ajo në ato çaste! Në dufin e një dashurie tē singertë, bërbëllita:

— Meleqe, mblidhe mëndjen... Askush tjetër pérveç teje...

Atëhere, ajo u hodh e foli zëlartë, në mënyrë që ta dëgjonin edhe matanë derës:

— Nëm ndonjë libër pér tē lexuar.

— A e ke lexuar «Magdalinen»?¹⁾

— Po.

— Merr «Verterin» atëhere.

— Ma jep, — shqiptoi ajo buzagaz.

Ç'prej atij çasti, asnjë vajzë tjetër nuk më hyn-te në sy. Paskëtaj, vetëm te martesa më rrinte mendja. Se, skundër e përmenda, unë kisha lindur ve-tëm pér një jetë tē ndershme. Pér një jetë tē nder-

1) Përshtatje në arabisht e romanit sentimental tē shkrimtarit francez tē shekullit XIX Alfons Karra «Nën hijen e bli-rëve».

shme dhe familjare. Unë nuk isha Ali Jusufi me shokë.

Në një ndajnatë më erdhën ca miq e më thanë: «A dalim njëherë të provojmë fatin?» Ta provojmë, pos!

7.

Sot, tek po shkoja për në kafene, sesi më lindi vjetvetiu pyetja: «A mos vallë jam i dënuar t'i shohë bojën për tërë jetën kësaj buharie të urryer, që lidh rrugën Ali Hoda me «Sheshin e Ushtrisë»? Të panjohura janë për njeriun udhët e Perëndisë! Edhe ajo kënaqësi kalimtare, që do të ndieja atje në kafene, do të më braktiste menjëherë pasi të kthehesha në shtëpi. Këtë e dija nga përvoja. Tërë pamja e Abisisë më është zvjerdhur, si të qe surrati i ndonjë monstre. Mandej kanë gojë e thonë sejeta e njeriut na fillokérka tamam-tamam pas të gjashtëdhjetave. Sa do të desha të ajgëtoja qark vetes vetëm gjëra të reja, të thithja ajër të pastër, të bridhja mes drurëve hije plotë e mes vashave që enden gjithë madhështi. Sa mirë do të ishte të veja gjëkundi në ndonjë klub, mes défrimeve dhe shokëve të shumtë, të ndieja dhe unë një grimë ngrrohtësi dhe rehati, që të m'i dëbonin mendimet mbi vdekjen dhe mbi një sërë sémundjesh të tjera. Në këtë botë s'mund të jesh i lumtur, po s'qe i ri dhe po s'pate para. Anekënd flasin për ca pasurira që sikur zbrësin nga qiejt, pa pritur e pakujtuar, për ca mbrëmje argëtimi nëpër dhoma të pajtuarat vetëm për një natë, e për disa «ballo» të arta nëpër hotele. Ku bie vallë ajo rrugë që të shpie në atë botë magjike?

O shokët e mi, ku jeni vallë? Një ditë hasa pra-

në kafenesë «Ameriken» mjekun Hazim Sabri, shternguam dorën njeri-tjetrit, shkëmbyem nja dy-tri fjalë dhe u ndamë! A do ta besonte kush po ta merte vesh se gjatë tërë viteve të fëmijërisë e të shkollës kishim qenë shokë të pandarë? Disa i ka rrëmbyer vdekja. Vetëm një plak babaxhan ka mbetur. Ja tek po ma bën me dorë nga ai vendi i tij i pérhershëm dhe më flet tërë seriozitet:

— Unë e di se ç'të ka prurë sot këtu kaq herët.

— Hë?

— Kriza e dollarit dhe e lirës egjyptiane.

Qesha me gjithë zemër, gjë që s'para më bën vaki.

— Allahut nuk i vjen keq për ty, o plak!

Ai foli rëndësor: — Të kam parë në ëndërr!

— Vërtet?

— Sikur i kishe hipur gomarit... e sikur ishe me një çallmë të madhe në kokë; mandej e hoqe çallmën e turde në ajër dhe e grahe hajvanin me thëmbrat e këpucëve. Unë të pyeta se për ku je nisur e po shkon e ti m'u përgjigje se kë marrë udhën e Mekës për haxhillëk.

— Por a s'më thua për mirë a për keq është kjo ëndërr?

— Sigurisht që ta them. Sipas meje, të pret një mbarësi, por më parë ti duhet të çlirohesh nga disa mendime të këqija!

Atë mbrëmje ndaj këtij njeriu ndjeva sërish njëfarë simpatie, sikundër dhe asaj dite kur ai më këshilloi t'i bëja një vizitë Meleqes. Ç'është e vërteta, Hamada ishte i vetmi që më thyente monotoninë e jetës. Po të mos ishte ai, do të shkalloja duke llafo sur tërë kohën me vete...

Pra, miqtë erdhën e më thanë: «Të provojmë fatin». Dhe ne vajtëm në kafene. Atje hëngrëm darkë nën tingujt e mandolinës. Aty për herë të parë zbraza një gotë të tërë me verë dhe, sakaq, ndjeva të ma përshkonin trupin ca drithërima të këndshme, siç nuk i kisha ndier kurrë gjer atëhere. Ne për herë të parë po hidhnik një hap të pavarur në jetën tonë, ndaj dhe na ngjante kaq interesante e kaq joshëse e prapë kjo këershëri s'përfundoi veçse me një aheng të zakonshëm. Nuk e përmbanim dot gjëzimin që na mbushte zemrat dhe filluam pa asnje shkak të qeshnim fort e më fort, aq sa i mërzitëm edhe disa pijanikë të rregjur, ulur në tryezat aty pranë. Ishte, pra, hera e parë që ne po shkelnim në rrugën e mëkatit. Sikush shkoi me femrën, së cilës i kishte vënë syrin. Unë ende s'kisha mbyllur derën, kur ajo, me një lëvizje të shkathët e të mësuar, zhveshi fustanin. Stepa në vend i trembur, zemra mend më ndali, si të më kishin kredhur në një fuçi akulli. Ajo më përfshiu me një vështrim përbuzës nga koka gjer te këmbët dhe ashtu siç isha, i mpirë i téri, e dëgjova tek më tha: «Eh ti, por ti ç'më ke mua, motër më ke?» Kur dola vrikthi në ajër të pastër stomaku më rebeloi dhe i zbrazi të gjitha ç'kishte brenda. Dikush nga miqt e mi shprehu hamëndjen se rasti i parë gjithmonë kështu përfundon, me pasoja të hidhura. Por edhe rasti i dytë qe akoma më keq. M'u tipos se lumturinë s'do ta gjeja dot as tek gota e verës, as tek këto gra. C'u bë vallë ai zjarr që më digjte e më përvélonte në prani të Meleqes? Ali Jusufi bëri një shenjë nénvletfësimi me dorë dhe tha:

— Ti qenke mysliman jo vetëm nga ndjenjat, por edhe nga stomaku.

Pra, m'u mbush radakja se përveç rrugës së nde-rit dhe një martese të ligjshme s'kishte shteg tjetër për mua. Endrrat e mia ishin modeste dhe s'kérkonin shumë mund për t'u realizuar. Unë s'doja veçse një punë pak a shumë të përshtatshme dhe një grua që të më bënte të lumtur. Gjithë dëshirat e tjera m'u tretën në një kohë të shkurtër si ato endrrat pasi zgjohemi nga gjumi. Miqë e mi rrahin lart, ata synojnë të vërtiten në sfera të tjera të panjohura. Ata i josh pushteti ose shkallët e nëpunësisë shtetërore. Disa syresh kanë hyrë në lloj-lloj partish dhe në-për mbledhje rrinë krah për krah me udhëheqës. Unë nuk mëtож për asi gjërash, unë kam nevojë vetëm për një ofiq që të më sigurojë mjetet e domosdoshme të jetesës, për një grua të ndershme dhe për fëmijë. Ja ç'më tha im atë në kulmin e luftës politike që kishte shpërthyer në të gjithë vendin:

— Ne, nëpunësit, i qëndrojmë besnik atij që kemi në krye të vendit.

Lart e poshtë nëpër biseda kisha dëgjuar se ka udhëheqës të ndershëm dhe udhëheqës maskarenj. Këtë ia thashë tim eti. Ai m'u përgjigj:

— Të gjithë derrat një turi kanë. Ata kacafyten me njëri-tjetrin për një copë kolltuk. Vetëm të çmendurit mund ta vënë jetën dhe të ardhmen e tyre në rrezik në një luftë që nuk i duhet askujt.

9.

Kudo goftë, në zyrë apo në kafene, ai s'flet përgjë tjetër, veçse për ofiqet, për postet dhe për organikat. Unë jam nxënës i zellshëm, paçka se nuk para shkëlqej në mësime. Mendjen nuk e vrash fort dhe nuk përpinqem të jem i pari i klasësë. Unë edhe libra lexoj, edhe argëtohem, edhe dashuri bëj. Tërë

shokët e mi janë të një mendimi se Meleqja e dashur
është vajzë e bukur dhe e sjellshme. Ajo më bënë
për vete çdo ditë e më tepër. Unë çmëndem pas saj
dhe ma ka këndë të mos i ndahem për asnjë çast.
Kur e kur ajo mrrolet në fytyrë dhe më thotë me
një zë të ëmbël:

— Po e zgjate shumë, prit pastaj skandale!

I përgjigjemi si me të qarë:

— Meleqe, s'duroj dot pa ty.

Ajo më qorton:

— Herë-herë sikur e tepron me mua dhe kjo
s'më pëlqen. Nga natyra e saj, dashuria është një
ndjenjë fisnike. Sillu pra me mua, ashtu siç sillem
unë me ty.

10.

Ajo më dhuroi fotografinë e saj dhe unë e ruajta
në gji, pranë zemrës. Dashuria më bëri të lumtur si
s'kisha qenë kurrë asnjëherë më parë. Mbi mua vërs-
shuan ca dëshira rimore, të cilave, ndryshe nga Ali
Jusufi, nuk po u bëja dot ballë. Ndër gjithë shokët e
mi ai është më i miri. Mësimet i përgatisnim së ba-
shku, herë në shtëpinë e tij, herë në timen. Ai vinte
më i shkurtër se unë, veç që më i zgjuar dhe më i
bukur në fytyrë. Kur e kur më shpjegonte ndonjë
mësim, që unë nuk e përtypja dot. Ishte më i ditur
sesa unë, madje interesohej edhe për problemet po-
litike. Ali Jusufi më flet me shpirt:

— Unë do të arrij ta shoh Egjiptin pa mbret dhe
pa anglezë.

Ali Jusufi më sqaron edhe për rrymat e reja po-
litike, siç janë, për shembull, «Vellezërit myslima-

në»,¹⁾ marksistët dhe «Egjipti i ri».²⁾ Ai i mbeti bësnik «Vafdu-së». Një kohë të gjatë u takua më një vajzë çifutë, e cila në fillim të Luftës së Dytë Botërore u zhduk pa një gjurmë. A pati vallë lidhja dashurie me ndonjë vajzë tjetër? Ja, këtë unë nuk e mësova dot kurrë. Madje, kisha përshtypjen se ai, në përgjithësi, nuk i përkushtohej dot një ndjenje të thellë. Në fakultetin juridik hymë njëherësh dhe pos së toku vazhdonim t'i përgatisnim detyrat e shtëpisë. Një ditë i thashë Meleqes:

— Edhe pak vite na kanë mbetur. Së shpejtë do ta fillojmë edhe ne jetën e re.

Në shtëpi, me të ëmën, vetëm Meleqja kishte mbetur, megjithqë ishte ku e ku më simpatike se të motrat, që ishin martuar prej kohësh. Ajo më tha:

— Ah sikur të kisha mbaruar edhe unë një shkollë!

— Të pëlqen të punosh në zyrë?

— E pse jo?

— Po unë të dua zonjë shtëpie.

Unë nuk jam nga ata që ia mohoj gruas të drejtët e arsimit dhe të punës; veç Meleqen e desha të ishte shtëpijake. Ali Jusufi më kritikon e më quan konservator e kaluar konservatorit.

— Me sa shoh unë, ti më tepër heq nga stomaku se sa ngajeta e re.

1) «Vellezërit myslimanë» — Lëvizja fetare politike në një sërë vendesh të Lindjes së Mesme, që lindi në vitet 1928-1929 në Egjipt. Idhtarët e saj ishin për një rrugë të veçantë «islamike» të zhvillimit, për një kthim në pastërtinë fillestare të islamit.

2) «Egjipti i ri» — parti mikroborgjeze nacionaliste, që ka ekzistuar në Egjipt në vitet 1933-1953 me emra të ndryshëm.

— Mos u tall — ia ktheva — Ke për të parë po nuk krijova një familje model, shumë më të lartë se këto që ti sheh rrëth e rrrotull.

Studimet ne i mbaruam në prag të luftës dhe u bëmë, siç i thonë, «zotërinj me shkollë». Diplomave nuk para ua pamë hajrin dhe nuk zumë ndonjë vend kushedi se çfarë. Unë, për shkak se nuk e bëja qejfin qeder, Ali Jusufi — për shkak se merrej me vepriktari politike. Aliu binte kushuri me zotin avokat Gafar Barham, i cili e mori në zyrën e tij. Im at nuk la gur pa lëvizur, gjersa më rregulloi në Ministrinë e Kulturës. Po të mos ishte plaga e Fiqiries dhe e Zejnabit, ai do ta quante plotësisht të përfunduar misionin e tij në jetë. Gjithsesi, në krahasim me familjet e tjera ne ishim më të lumtur. Vëtë-kuptohet, jo kaq të lumtur sa familja e Baham-efendi Osmanit, babait të Meleqes. Pasi fillova nga puna, vizität e mia në shtëpinë e saj frymëzoheshin nga qëllime të tjera. Ne tani bisedonim haptazi dhe jo me gjysmë zëri dhe as me hamendje dashurie për të ardhmen e jetës sonë të përbashkët. Unë i flisja si t'i kërkoja të falur:

— Tani një punë të mirë nuk e gjen dot as me qiri në dorë.

Meleqja më përgjigjej nurqeshur:

— Të kuptoj... Mos u mërzit se me kohë do t'ia arrijmë edhe ne qëllimit tonë.

— Tetë ginei na mjaftojnë.

— Na mjaftojnë e na teprojnë.

— Ishallah, nuk zgjatet shumë ajo që quhet periudhë prove.

E ngazëllyer, ajo miratoi me krye shpresën time dhe faqet iu flakëruan. Tek më solli kafenë rrëja dhe sodisja figurën e saj elegante. Një drithërimë më kaloi nëpër trup dhe sakaq pyeta veten: «Po sikur

ta kishim shpallur fejesën a do të mundesha vallë t'i afrohesha e t'i afrohesha?»

11.

Hamada vërejti me shpoti:

— Kur po luanim tavllë ti e kishe mëndjen në vend, tani dukesh si i hallakatur. Ç'ke kështu, sikur të janë mbetur gjemitë?

Unë kundroja i nemitur truket e një prestigjitor, para kafenesë, mes një trumbe fëmijësh. U rrënqetha i téri kur një gjarpër iu përdrodh rrëth qafës.

— I ke qejf prestigjitarët?

— Jo.

Iu shkëput një pshëretimë dhe shqiptoi:

— Kam një nip sëmurë rëndë.

— Zoti e ndihtë!

— A të kujtohet ajo poezi që fillon me vargjet: «Dhe ju o fëmijë, shembëlleni...» Hë, vazhdoje.

— Se ku e kam lexuar dhe unë, veç kam një të keqe, që nuk e mësoj dot përmendësh poezinë.

— Edhe unë tani e harroj atë që s'duhet harruar dhe ndërmend atë që nuk e vlen të kujtohet.

— Qënkemi njësoj.

— Madje kur e kur harroj dhe rregullat gramatikore që i kam shpjeguar gjithë jetën.

12.

Babai doli në pension bash atij viti që unë nisa punën. Në fytyrë i këndohej një si trallisje si dhe një ndjesi tjetër, të përafërt me turpin, çka ai rrithet ta fshihte pas një buzëqeshjeje të zoritur. Dhe unë thashë me veten time: «Më qenka mërzitur ba-

bai». Ai mundohej të ishte strikt në zbatimin e rregjimit ditor: binte në gjumë aty nga mesnata, çohej rrëth orës tetë të mëngjezit, në vend të orës shtatë që ngrihej më parë, dilte nga shtëpia mbasdite, kthehej nga kafeneja «Davavin» në vend të ministritë që kthiehej dikur, hante drekë, dremiste një copë herë dhe ia mbathë sërisht për në kafene. Përherë i murrëtyer. I dhashë karar ta ngushëlloja e t'i gëzoja, makar dhe fare pak, zemrën. Përveç se baba, unë e kisha edhe shok, ndaj dhe s'kishte arsyen pse t'i lutesha. I thashë: «Baba, hajt t'i vemë Baba-efendi Osmanit në shtëpi, t'i kërkojmë dorën Meleqes. Le të jetë kjo për ne një ditë vendimtare. S'ka hiç kuptim të presim sa të martohet Fiqiria dhe Zejnabi, se ashtu siç e kemi nisur, kjo punë as në fund të shekullit s'ka për të bitisur». Por do ti, i ziu baba, më vdiq krejt papritur. Ai nuk vuante nga asnje sëmundje dhe për asgjë nuk dyshonte. Kjo ndodhi një mëngjez herët, në tryezën e sillës, ndërsa po rrufiste kafenë. I erdhi nga dambllaja, na tha mjeku më vonë. Gratë vunë kujën dhe corrën faqet. Edhe unë qava me logori, së bashku me gratë, si të isha një grua. Babanë e doja mbi të gjithë. Vështirë t'i besojë vdekjes njeriu në atë moshë që isha unë.

— S'ka më të lehtë se vdekja nga dambllaja, — thoshte ai dhe sillte si shembull të atin.

Vdekjen e besoja, por se do të vinte një ditë e do të ndeshesha me skamjen — kurrë. Ajo ia behu krejt papritmas, ndonëse për një kohë të gjatë kishte qenë pranë meje. Vetëm mbas vdekjes së babait m'u mbush mendja se edhe ne ishim të varfër, si mjaft e mjaft të tjerë. Gjer atëhere pata jetuar në një botë shpresash iluzore. Çuditesha si babai s'na kishte lënë asnje pasuri, por vetëm nja dyzetë gine, që ia kishte dhënë nënës për shpenzimet e va-

rrimit. Por si shpjegohej ai bollëk, në të cilin pat jetuar familja jonë? Shumë thjeshtë. Bota ndodhej në darën e një krize globale, gjë që e kisha lexuar edhe në gazetë, por nuk i kisha dhënë rëndësi. Njerëzit e zënë me një punë të pérherëshme siguronin një farrë mirëqenieje me ato pak të ardhura që fitonin. Mallrat e lira bliheshin, në radhë të parë, nga nëpunësit. Falë kësaj, pra, ne hanim, pinim, visheshim e krenoheshm që banonim në Kajro. Si plasi lufta, gjithçka ndryshoi. Nisi bumi tregtar. Çmimet ngriheshin me hapa galopante. Pronarët e morën veten. Ata që lufta i pasuroi mbushën qypa të tërë me florë. Gjendja u keqësua vetëm për nëpunësit e thjeshtë. Vetëm këtyre e ardhmja nuk u premtonte vëçse re të zeza. Dhe ja, në këtë e sipër, një djalosh i përkëdhelur na bëhet kryetar familjeje, përgjegjës përfatë e një nëne dhe të dy motrave, të mbetura lënuesha. Pensioni i tyre mizerabël nuk dilte as përrrobat e trupit, ndërsa me rrogën time mund të blije përditë e më pak sende. E pra, a kisha të drejtë unë ta zija në gojë fejesën në këto kushte? E prapë, a s'kisha të drejtë unë të pyesja se a do të martohensha vallë, ndonjëherë?

U takuam në shtëpinë e saj, pas të dyzetave të babait. Vetë atmosfera e takimit ishte një ogur i keq. Isha ende nën pushtetin e zisë, por edhe ajo e respektonte dhimbjen time. Ndaj kurrë nuk e kisha parë kaq të brengosur.

I fola si i zënë në faj:

— Fakti që babai s'më la asnje trashëgim, është një grusht i rëndë për mua.

Ajo pyeti e vrerosur:

— Po pensioni?

— Hë, pensioni! E ç'pension zeza është ky, moj Meleqe?

- Tërë kjo ngjet me një vrasje të paramenduar.
- Qe vërtetë një vrasje.
- Ç'mendon pér të ardhmen?

Ndonëse ishim që të dy pikë e vrer, pasioni m'u rinden pér të me një hov të ri. Apo mos ndofta hidhërimi i hodhi karthje këtij flakadani të zhuritur? Madje më feksi në kokë mendimi i çmëndur pér ta përdhunuar. Ne u ndamë tejet të alarmuar. Si edhe kur do të martoheshim? Ja pyetja që më dërrmonte orë e çast. Gjithë kolegët e mi në ministri qenë bërë me familje. Ata nuk dinin se si ta shpjegonin arsyen sepse kisha mbetur beqar. Mjaft syresh tregohe-shin të gatshëm pér të më gjetur nuse: «Po kjo është një gjë kaq e thjeshtë». Veç ata ishin përfaqësues të një brezi rebelues, të zhytur në mëkate. Nuk e kisha menduar kurrë që fati do të më punonte një rreng të tillë!

Nëna më erdhi një ditë me petkun e zisë dhe m'u ul pranë, në divan. Më foli syulur:

- Besoj Halim se do të më japësh të drejtë.
- Nuk e pikasa se ku i rrihte, ndaj e pyeta:
- Ndonjë haber të ri?
- Nuk di ç'të them.

Heshti një grimë dhe vijoi:

— Sot që pa gdhirë, trokiti në derë e éma e Meleqes. Kemi qenë shoqe fëmijërie dhe është e drejta e saj të interesohet pér fatin e së bijës. Më doli me propozimin ta shpallnim fejesën dhe më pyeti pér të ardhmen tënde. Ja ç'i thashë: «Të kam shqen time më të ngushtë dhe me ty s'mund të flas ndryshe, veçse, më zemër në dorë. Edhe Meleqen e kam njësoj si bijat e mia dhe e di se Halimi nuse më të mirë, më të bukur, më të edukuar dhe më të fisme s'ka pér të gjetur. Po ti duhet ta kuptosh gjendjen tonë të tanishme». Dhe pasi ia rrëfeva të gjitha

fill e për pe nuk ndenja pa e pyetur: «Më thuaj, po na braktisi Halimi, ne ku të mbytemi?» «Po ç'na pengon ta shpallim fejesën që tani, në mënyrë që të mbyllen gojët e liga?» «Po ku e dimë ne se kur do t'i krijohen mundësitë atij të mbajë dy kunguj nën një sjetull?» Dhe u ndamë — unë pikë e vrerë, ajo hundë e buzë. Hë, bir, gjykomë, mos kam bërë ndonjë gabim?»

Vetëdija e pafuqisë sime më tërboi nga inati. Po kë të shaja e kë të qortoja? Murit nuk i bihet me kokë. S'isha e s'isha i zoti të mposhtja atë fantazmë kobtare, e cila kishte emrin prapësi. E urreja jetën. O kohë e rëndë, o kohë e tmerrëshme!

E mblodha dhe u nisa për në shtëpinë e së dashurës. Për herë të parë më priten ftohtë në atë fole dashurie dhe ëndrash të trëndafilita. Meleqja rëndë-rëndë, me një fytyrë të vranët e të zbehtë dhe e ëma mu në mes të dhomës së pritjes si ndonjë mbretëreshë. Më pyeti me qesendë:

— Para se të vije këtu, ai i more leje satë eme?

Mandej ndërroi tonin dhe foli e dëshpëruar:

— Jo, këtë pabesi nuk e prisja!

— Po ju jeni në dijeni për kushtet tona, — iu përgjegja me një fije zëri.

— Allahu s'ka për të ta falur. Si është e mundur që një djalë si ti, të sakrifikojë jetën për shkak se kësaj apo asaj nuk i del fati? Pastaj, ç'faj ka ime bijë në këtë mes?

— Më lejoni të shpjegohem...

Por ajo s'më la të mbaroja fjalën:

— S'më interesojnë sqarimet e tua. Mbi të gjitha, për mua ka rëndësi emri i mirë i vajzës sime dhe e ardhmjë e saj.

— Unë nuk e vë kurrë në dyshim nderin e Meleqes! — protestova.

— Oh, jo vizitat e tua tani mund të shihen me sy tjetër dhe të më dëmtojnë vajzën.

— Nënë! — thirri Meleqja.

— Ti qepe! — e bëri zap ajo.

M'u errën sytë dhe u largova me bisht ndër shalë nga ajo shtëpi. Ecja duke u lëkundur, nuk e duroja dot fyerjen që më kishin bërë si dhe hidhërimin dhe pezmin tim. Mos vallë gjithçka kishte marrë fund? Edhe dashuria, edhe shpresat? Madje dhe martesa me Meleqen? Dhe të gjitha dhe të gjitha? Ndjeja si më kamxhikoste një urrejtje e llahtarrshme dhe e papérmbajtshme ndaj botës mbarë. Po më zinte frymën hamendja se mos isha viktimë në një familje viktimash. Në shtëpinë time asaj mbrëmjeje mbretëroi po ajo atmosferë zie, si ditën e vdekjes së babait. Nëna, Fiqiria dhe Zejnabi rrinin pranë e pranë në një divan, pa guxuar të ngrinin sytë nga turpi dhe marazi. Nëna u hodh dhe foli fajtore.

— Ne jemi një barrë e rëndë për ty, po ja që më fatin nuk luftohet.

Më tepër i dhimbsesha Fiqiries se sa nënës. Nuk i harrojë fjalët e saj:

— Motra jote edhe malet do t'i përbyste vetëm që ti të ishe i lumtur, po ç'mund të bëj unë?

Jo më pak e tronditür se e motra dhe e ëma, Zejnabi s'bëzante. Vetëm kur po ikja për në dhomën time ia dégjova psherëtimën:

— U bëftë dëshira e Allahut!

13.

Tani sa herë kthej sytë pas nuk shoh veçse hiçësinë, mizerabilitetin dhe mjerimin e jetës sime, shoh éndrrat gënjeshtare, plot me pasurira e me gra si dhe këtë shtëpi-burg, në rrugën Abu Hoda. Dhe Ha-

mada at Tartushin, që s'më duron dot të mërzitur, ndaj më cyt gjysmë me shaka e gjysëm seriozisht:

— Shkoji, pra, se edhe ajo ka mbetur qyqe, njësoj si dhe ti.

Edhe tani, sikurse dhe në të kaluarën e largët, Meleqja po më zgjonte dëshirat e fjetura. Sa e sa herë e shihja veten më sytë e mëndjes, duke e shternguar fort e më fort atë pas kraharonit tim.

Hamadës meazallah se i pushon goja:

— Sikur të qe një kohë tjetër, ti fare mirë do të mund të gjejë një grua, e cila do të të siguronte gjithë assortimentin e shërbimeve komplekse! Dhe duke kakaritur shton: Pak a shumë si ajo puna e «zhvillimit tonë kompleks».

Plaku, dreqi e marrtë, është në qejf, ndaj nuk undahet rrromuzeve:

— A të flasim açik? — vijon ai — Ti edhe tani mund të martohesh me Meleqen.

E këqyra me inat.

— Po të kisha qenë në vendin tënd, — tha ai, — do t'i kisha blerë mobiljet e dhomës qoftë edhe më këste dhe vajzës do t'i kisha vënë krahun dhe do ta sillja në shtëpi e më tej, si të bënte emër Allahu.

Ja preva vrazhdë:

— Atëbotë nuk m'u dha ta bëja këtë gjë.

— Mos u nxeh se të fola ashtu, se e shoh që e ke humbur pusullën dhe ke rënë moralisht.

— Mos më bjerë në qafë kot. Pse, faji im është që linda pa këmishë?

14.

Mirë thonë, të këqijave kur vijnë hapu derën. Njerëzit e shtëpisë kishin zënë dhe po i hanin kokën njeri-tjetrit: Fiqiria i hidhej në fyt Zejnabit dhe

Zejnabi asaj, nëna grindej dhe stërgrindej me Fiqirien, Zejnabi bëhej helaq me fjalë me nënën e kësh-
tu me radhë dhe kështu pasosur.

Fiqiria hidhet e thotë:

— Po të kishim mbaruar edhe ne shkolën, do të ishim selitur, diku, në ndonjë punë dhe s'do të ishm këtë derexhe. Allahu na ndjeftë!

— Ishte kohë tjetër atëhere, moj bijë, ndaj mos i bjerë havale tët eti.

Ndërhyn Zejnabi:

— Një çikë të isha treguar më e guximshme, do të kisha hyrë në punë si shërbyses.

Në këto e sipër nëna klithi:

— O zot, merrmë ymrin një sahat e më parë!

O shtëpi magjiplate, o shtëpi mynxyrëmadhe! A do të mbarojnë vallë, ndonjëherë, këto rrromuze të padurueshme? Në të njëjtën kohë, ato sillen me mua me kaq dashuri dhe me kaq dhimburi, sa ç'kish ku të shkonte. Unë isha kryetari i kësaj familjeje, një-kohësish edhe viktima e saj. Unë ato i urrej, po aq dhe sa i dua dhe po aq edhe i mëshiroj. Ç'amvisë e mrekullueshme ishte nëna ime! Dhe sa mirë mirëkuptohej ajo me babanë! Jo, jo, kurrë nuk ma kishte marrë mendja se do të kishim pasur këtë fund. Një ditë, tërë mllef, siç isha, pyeta nënën:

— Po s'i s'pamë një ditë të bardhë, xhanëm?

— E po uthulla s'bëhet mjaltë, mor bir. Se edhe ti..., — m'u përgjegj ajo.

— Ç'do të thuash me këtë?! — u revoltova.

— Dua që ato të martohen, në mënyrë që të të hapet rruga ty, mor bir.

— Po ja, të themi se u bë e pamundura e mbiu një dhëndër nga dheu, po nuk më thua ç'mund t'i japim ne atij? — pyeta me kast.

Nëna pshërëtiu dhe mbylli gojën. Mua s'm'u durua dhe ngrita zërin:

— Ik, pra, martohu dhe lërna rehat ne në punën tonë, — tha ajo e kreshpëruar.

— Madje edhe këtë nuk e bëj dot, — ia prita të-rë pikëllim.

Urrejtja për këtë shtëpi fatkeqë më shtohej përditë e më tepër. Gjithë po ato fytyra e gjithë po ajo skamje. Pse, kështu do ta lëbyr unë këtë jetë? Fiqiria është bërë nevrike, Zejnabi — egoiste. Ato s'dalin nga shtëpia jo vetëm sepse garderoba u është varfëruar, por edhe se s'duan të shohin njeri me sy. Ndërkaq, lufta vazhdon, çmimet ngrihen, hallet shtohen. I them nënës:

— Ne nuk i shtrijmë këmbët sa kemi jorganin, duhet të jemi më të përkorë në të ngrënë e në të pirë.

— Unë bëj aq sa mundem, mor bir.

— Babai, ndjesë pastë, nuk u përpoq për të ardhmen tonë!

Edhe kësaj radhe ajo mbajti anën e të shoqit:

— E po, kaq e pati takatin, mor bir.

— Po ai dhe atë pasuri që kishte e bëri rrush e kumbulla. Duke më mbajtur në pëllëmbë të dorës dhe duke më trajtuar si manare më prishi jetën.

— Edhe ti, që të donte si sytë e ballit, po e përgojon?

— Duhej të qe treguar më i mënçur, të kishte vënë ca para mënjanë, që të lehtësonte, ashtu, martesën e të bijave.

— Për këtë qëllim ai kishte bërë niet të kursente nga pensioni i tij.

Njëherë shefi më lajmëroi se me kërkonin në telefon. Vajta, ngrita dorezën dhe posa dëgjova zërin e saj, zemra më rrahu me furi. Po, ishte Meleqja,

Meleqja ime e shtrenjtë. Pikëpjekjen e lamë ndaj-natëherë në rrugën e Pallateve. Po takoheshim, pra, mbas një viti, kur më qe shuar çdo shkëndi shprese. Përpara më doli po ajo fytyrë ëngjëllore e po ai kurm i përsosur. Flakë e kuqe në fytyrë, ajo foli e para:

— Sigurisht që më ke harruar!

Lëvizëm nga vendi, krah njeri-tjetrit.

— Kurrë nuk e kisha menduar se gjithçka do të mbaronte ashtu siç mbaroi, — thashë me një zë të këputur.

— Sa propozime pata dhetë gjitha i hodha poshtë. Po tani si t'ia bëj?

— Meleqe, jam fajtor para teje.

— Domethënë, asnje shpresë.

— Në mos u bëftë edhe më keq akoma!

Ajo vaisi kryet.

— S'do të ishte e ndershme nga ana e ime të të gënjeja, — vijova.

Çapitem gojëkyçur, gjersa dolëm përpara spitalit francez.

— Unë do të veproj siç do të më këshillosh ti, — murmuriti ajo.

— E ç'këshillë mund të të jap unë? Tani mua s'më mbetet, veçse të pranoj fajin për tërë ato vite që të shkuan dëm, duke më pritur.

Errësirën, që po dyndej me shpejtësi, nuk e përzinte dot as drita e fenerëve të rrugës, lyer me bojë të kaltër, siç e kërkonin rregullat përkatëse të mbrojtjes kundërajrore. Një errësirë kjo që të shtypte me peshën e saj të rëndë. Ne duhej të ndaheshim para se të mbërrinim, në al-Abisi. Një ndarje përfundimtare që do t'i merrte me vete të gjitha! Ndalem. E pyeta me një zë drithërues:

— Më thuaj Meleqe, a i kam hak edhe sharjet më të ndyra?

Ajo mohoi me krye. Duart tona u tokën. Ja dhe fjalët e mbrapme, që i thashë:

— Meleqe, sa të jem gjallë do t'i lutem Allahut që ti të jesh vetëm e lumtur!

Mezi e këputa vështrimin prej saj dhe ika. Ky takim vetëm se e acaroi edhe më plagën edhe ashtu të hapur. Botën rrëtheqark atij çasti e urreva me një forcë të re, madje paskëtaj u bëra edhe një lexues i rregullt i shtypit të opozitës, sado që politika kurrë s'më kishte tërhequr seriozisht. Rasti e pruri që të pyes mikun tim, Ali Jusufin:

— Ti që na hiqesh si i ditur, na jep një mëndje. Me ç'duken bathët, jetën do ta ngrys beqar, ndaj më thuaj si t'i zgjidh problemet e mia si mashkull?

Ai qeshi me zë të lartë — këtë bisedë po e bënim tek shëtisnim nëpër parkun al-Ezbekija — dhe më tha:

— Provoje një herë fatin kafeneve.

— Por unë nuk i honeps dot as ato gra që e kanë zanat atë punë, as edhe verën, — ia ktheva shpresëhumbur.

Ai vazhdoi në të tijën:

— Atëhere s'të mbëtet veçse t'i vesh Um-Abdos.

— Um-Abdosë? — u çudita.

Ai vazhdoi pa e prishur terezinë:

— Ajo në shtëpinë tuaj është rritur. Jeta i vajti ters, por si femër ende mbahet. Pse të mos e provosh?

— Po ajo është dhjetë vjetë më e madhe se unë?

— Por se mos të thashë që të martohesh me të, or profesor.

15.

Në tërë rruzullin tokësor si zor se mund të gje-je një vend kaq të mbyllur e kaq të humbur si ndër-tesa e vjetër në rrugën Abu Hoda dhe kafeneja «Mbrothësia» në Sheshin e Ushtrisë, ku bashkëjet-tonin pranë e pranë tërë ato èndrra magjiplotë. Për-veç èndërrimeve q'i mbetej tjetër një pensionisti? Po të kisha para nuk do të rrija pa i rënë tërë Egjiptit kryqetërthor — nga Lindja në Perëndim dhe nga Veriu në Jug. Dhe sikur të më dërgonte ndonjë i afërm andej nga Brazili pasuri të madhe, do të shë-tisja gjithë botën dhe do të martohesha me një bu-kuroshe të re, pa e vrarë mëndjen për pasojat. O zot, sa të èmbla dhe sa të pamëshirëshme që janë këto èndrrat! O Meleqe, po unë të kam këtu fare pranë dhe s'po bëjë asnë përqapje të vij e të jem pranë teje. Sa e sa kujtime na lidhin ne të dy, o Me-leqe, ne të dy që jemi viktima po të një brezi! Ze-mra më thotë se femra te ti ende s'ka vdekur.

16.

Hamada at Tartushi më njoftoi tërë gëzim:

— Djalin ma ngriten një shkallë më lartë, ma bënë drejtor të përgjithshëm.

E urova, duke i thënë:

— Epo sot e kam hak kafen dhe sanduiçin.

— Vetëm kafen! — ma preu ai.

— Ti ende vazhdon të jetosh me bashkëshorten tënde si burrë e grua?

— Ç'pyetje prej budallai! — m'u përgjegj Hamada buzagaz.

— Më fal, por për mua kjo ka rëndësi.

— Sa herë të më teket, — më sqaroi shkurt ai e sakaq shtoi:

— Jo gjithmonë mundësitë përputhen me dëshirat.

E pas pak foli me një farë keqardhjeje:

— Po si mbete ashtu bëqar ti? Ti që të qante syri për një grua?

— Deri vjet kisha në ngarkim tërë familjen, — ia prita i pikëlluar. — Dhe sa herë do të ngriheshin pak rrogat, çmimet do të rritheshin dyfish.

— Ç'hata! Um Ubdoja e hëngri çairin, para kohe.

— Përkundrazi, me vonesë, pasi pushoi së qenuri femër!

— Ashtu qe shkruar. Po tani pse nuk vete ta takosh Meleqen?

Ali Jusufi m'i kishte ngulur sytë. E nuhata se diç kishte për të më thënë, por shtiresha sikur nuk e vija re. Ishim ulur në kafenenë «Gëzimi», një kafene e vjetër, ngritur atje, ku tani është hapur një ekspozitë mobiljesh. Më në fund më pyeti:

— Po me Um Abdons sì iaçon?

— Ishte thjesht një nga ato aventura që, zakonisht, kurorëzohen me sukses, — ia pata duke nënqeshur.

— Po hë, më trego!

— Ç'të të tregoj? Një shprehi shumëvjeçare dhe asgjë më tepër. E njihja që fëmijë, më ishte bërë si një orendi shtëpijake. Kur u bëra kryetar familjeje ajo e shtoi respektin ndaj meje. Dhe kur unë fillova ta shikoja me sy tjetër e t'i flisja me ëmbëlsi, asaj sikur nuk i besohej. Vetëm budallaçkat nuk i vënë re gjëra të tillë. E ajo, ndonëse një grua e thjeshtë, për fat të mirë nuk është gjysmake. Sapo i hoda dorën, u skuq gjer të veshët, u sbraps dhe shpe-

shtoi frymëmarrjen, e alarmuar. Tani gjithçka shkon si në vaj, veç më duhet të tregohem tepër i kujdes-shëm.

— U trëmbesh skandaleve?

— S'do mend.

— Ato s'mjafton që të lanë pa martuar, po tani duan edhe të të torturojnë.

— Mua më përmban namuzi dhe rregullat e mi-rësjelljes.

— Rëndësi ka që tani je në rregull me nervat, apo jo?

— Gjynah të qahem.

— Sidoqoftë, po ndodhi gjë, njoftomë.

— Kopil a kopil, ti dhe plumbin në gojë e ke pak, — bëra shaka.

Po, vërtetë, unë e qetësova, por veç në të njëjtën kohë, ndjeva se vetja m'u pështiros, kuptova se isha krejt i pafuqishëm dhe se nuk vleja më pér as gjë. Pyesja vehten: ç'ndryshim kishim ne nga vendet pjesëmarrëse në luftë? Ne qemë mësuar me lebetitë e saj, me sinjalët e alarmeve ajrore, qemë mësuar të shihnim ushtarët aleatë. Ne habiteshim me paqëndrueshmérinë e lumturisë së kohës së luftës dhe me shpejtësinë e rënies së idhujve të dikurshëm. Me Ali Jusufin piqeshim dy herë në ditë — mbrëmanet në kafe «Gëzimi» dhe mëngjes herët — po-shtë në strehim.

Në një ndajnatë, ai më tha:

— Desha të di mendimin tënd pér një çështje me zarar.

— Po të dëgjoj, — iu përgjegja, pa e ditur se ku e kishte.

Ehe ai më pyeti çehreprishur:

— Si i ke marëdhëniet tani me Meleqen?

Kjo pyetje më ra si bombë. Për disa çaste s'munda të shqiptoja dot një fjalë.

— Zëre se nuk e njoh.

— Nuk të pyeta pér marëdhëniet zyrtare, por pér ato intime.

— E kaluara u varros njëherë e përgjithmonë.

— Dhe s'do të vinte keq në se ajo do të martohen?

— Përkundrazi, do të më bëhej qejfi e do t'i uroja jetë të lumtur. E ndofta martesa e saj do të më çlironte përfundimisht nga një ndjenjë faji.

— Atëhere, dhe një pyetje tjetër:

— Ju dëgjoj, zotëri.

— A do të kishe ndonjë kundërshtim po ta kërkova pér grua?

— I pari do t'ju uroja, — ia pata aty pér aty.

— Veç të lutem folmë sinqerisht, në mënyrë që më pastaj, si unë ashtu edhe ti, ta kemi ndërgjegjen të qetë.

— Sinqerisht po të flas.

— Po, Aliut unë i fola hapur. Hidhërim që më pushtoi ishte vetëm i përkohshëm, i ndjellë nga zhgënjimi që pësova, por nuk ndieja më as dashuri e as xhelozë.

17.

Po atë ditë kur unë ia tregova gjithë këtë mesele xha Hamada at Tartushi, ai nuk harroi të më pyeste:

— Vërtetë nuk ke asnë ndjenjë pér Meleqen?

— As që mos e vërë në dyshim, — iu përgjegja i vendosur?

— Dhe s'do ta merrje pér grua po të krijoheshin rrethanat?

— Do ta merrja, posa jo, në se ajo do të ishte e denjë për këtë.

— Domethënë se ende vazhdon të ndiesh për tē?

— Edhe ndonjë tjetre mund t'ia vija gishtin.

Hamada picëroi sytë e vijoi:

— Më duket se më ke thënë që ata kanë banuar nën një çati?

— Po.

— Të betohem për Kaabën¹⁾ nëse ai nuk e kashashur atë prej kohësh, — foli Hamada me një pamje komplotistë.

— Edhe unë kam dyshuar për këtë.

— Pra, del se ky Ali Jusufi yt na paska qenë një skile me fytyrë engjelli!

— Me mua ai ka qenë korrekt dhe tërë jetën, derisa vdiq, ishte dhe mbeti miku im më besnik.

— Dhe ti nuk ishe kundër kësaj martese?

— Përkundrazi, plotësisht dakort.

Fill pas kësaj shtova dhe këto:

— Ata lindën dy djemë, po kaq të talentuar sa edhe i ati. Që gjithashtu u morën me politikë, por ndryshe nga i ati vafdist, ata u bënë anëtarë të organizatës «Vëllezërit mysliman» dhe më vonë u detyruan të emigrojnë në Arabinë Saudite. Atje u martuan dhe mbetën me banim të përhershëm dhe tani falë tyre Meleqja është me të gjithë të mirat.

— Po kur mbeti e ve?

— Para dhjetë vjetësh. Miku im vdiq nga kanceri në lulen e jetës. Ishte një burrë fisklik dhe i tillë mbeti derisa mbylli sytë.

1) Kaaba – Tempulli i myslymanëve në Mekë.

Të afërmit e mi e pritën në heshtje lajmin e martesës së Meleqes. Ata s'dinin ku të futeshin, aq rëndë u vinte nga unë. Atmosfera e shtëpisë, edhe kështu e zyrtë, u bë e skëtershme. Unë vajta në dasmën e mikut tim, madje dhe e përgëzova Meleqen, si të isha një njeri krejt i huaj për të. Veç fillova të mendoj i habitur sa gënjeshtare dhe sa kallimtare janë ndjenjat, sa fluturake janë ëndërrat e djaliqerisë dhe të rinisë dhe sa i hidhur dhe i mjerë është realiteti.

Sidoqoftë, Ali Jusufi ishte njeri i rrallë. Të ardhurat e tij si avukat ishin dhjetë herë më të mëdha se rroga ime në ministri. Meleqen ai e mbante në pëllëmbë të dorës dhe djemëve u dha një edukatë të shkëlqyer. Sa krenohej me sukseset, aq dhe shqetësohej për veprimtarinë e tyre politike. Jo vetëm se kjo binte në kundërshtim me bindjet e tij, por dhe sepse ata kërcënohen në përpjekjet e qeverisë. Ndaj dhe Ali Jusufi u gëzua kur djemtë i ikën në Arabinë Saudite, por shpejt zuri ta digjte malli për ta, si baba i dhimbës që ishte. S'kam për ta harruar kurrë atë përleshjen e tij të shkurtër dhe mizore me sëmundjen e llahtarëshme — kancer në fshikëzën e urinës — as vuajtjet e tij në grahmat e agonisë, as atë vdekjen e tij, pas së cilës më mbeti në zemër një boshllék i zi. I vëtm ngushëlim i imi aso kohe qenë disa përparime në punë dhe ato lidhjet e fshehta me Um-Abdonë. Iu nënshtrova realitetit që për mua e mishëronin tri gra histerike, pérherë të pakënaqura. Ato sikur ishin një simbol i gjallë i kohës që karakterizohej nga shtrenjtësia e jetës, nga një sërë kontradiktash dhe të këqijash të tjera.

Fill pas revolucionit¹⁾ shëndeti i nënës mori tätjetën dhe sëmundja psiqike e Zejnabit u acarua keq. Tani mbi shpatullat e mia rëndonin edhe shpenzimet e ilaqeve, edhe ato të mijekimeve. U mësova me jetën e beqarit dh dëshirat e vjetra për t'u martuar e për t'u bërë me fëmijë më dukeshin qiqra në hell. Pyesja veten me një farë pezmi: a do të mundja vallë të dilja nga kjo strofkë krrupëndjellëse, të dilja dhe të harboja i lirë? Sa më gëzonte aq dhe më brengoste fakti se ato të tria bënin çmos të më shërbënин dhe të më krijonin një komoditet të plotë. Komoditet ky që më interesonte më pak se çdo gjë tjetër. Në një kohë kur vitet ridhnin e ridhnin, ato më mbanin lidhur pas vetes me vargonj. Ja dhe Um-Abdosë i çatisi ora të vejë tek të shumtët. Kurse nëna, Fiqiria dhe Zejnabi më lanë vitin e fundit të punës. Në krye humba nënën, që atëhere ishte në një moshë të respektuar, mbas disa muajsh i vajtën pas Fiqiria, tanimë shtatëdhjetëvjeçë e mandej Zejnabi, që ishte dy vjet më e vogël se e motra. Për të përballuar shpenzimet e varrimit u detyrova të kridhem në borxhe. Dhe fill pas kësaj, në moshën gjashtëdhjetëvjeçare mbeta vetëm qyq në këtë botë të çmëndur e të çakërdisur, ku kokra e limonit kushtonte dhjetë piastra.

19.

Hamada at Tartushi më mban me gjajret:

— Mbaje veten. E di që shtëpia të është vështirësuar, por mos harro se me mijra të pastrehë, që

1) Është fjala për revolucionin e korrikut të vitit 1952, si pasojë e të cilit në Egjipt u përmbyss regjimi feudalo-monarkist.

dergjen gropave nëpër varrezat e vjetra, do të të kishin zili. Fare mirë mund të punosh në një shqëri private, në mënyrë që të shtosh sadopak të ardhurat e tua. Dhe pastaj pse nuk shkon të takosh një grua vetmitare, ashtu si dhe ti?

Dhe duke qeshur, shton:

— Allahut i qofshim falë, ti sa s'pëlcet nga shëndeti dhe më duket mua ke takat si mashkull, jo se s'ke, pra mendoj se nuk do të dalësh i turpëruar.

Në një mbrëmje të bukur i thashë:

— I dhashë karar t'i bëjë një sfidë fatit.

Plaku më rrahu shpatullat për guximin. Të nesërmën pjesën më të madhe të kohës e kalova duke u kujdesur për tualetin tim. U qetha, u rrojta, u lava, u shpëlava, vesha këmishën dhe pantallonat më të mira dhe prita derisa u err. Mandej dola në rrugën kryesore, së cilës i rashë mespërmes. M'u kujtua Ali Jusufi dhe thashë vetmëvete se ai kishte besim tek unë, por edhe unë, ama, s'po ia përlyeja kujtimin dhe se një burri në moshën time nuk i ka hije të qorollisej. Ndala mes errësirës së plotë para një dere në katin e tretë dhe shtypa butonin e ziles. Veshi më zuri ca hapa që po afroheshin. U çel sythi i derës dhe një zë fort i njojur pyeti:

— Kush është?

Mbi derën u ndez një dritë që më ndriçoi fytyrën. Meleqja s'po u besonte syve të saj.

— Ti?

Hapi derën. Zëri i dridhej nga emocioni. Më rrëfeu me dorë një dhomë në të djathtë të hyrjes dhe murmuriti:

— Hyr, të lutem, hyr.

Meleqja doli dhe unë mbeta vetëm. Po më mbyste zagushia. Çela dritaren që binte në rugë. Po ajo dhomë e vjetër dhe e njohur pritjeje, veç mobiljet qenë të reja dhe të modës së fundit. A do të pendo-hesha vallë pér këtë dalldisje? Me siguri. Meleqja tani po rivishej. Kishte kaluar një kohë e gjatë që s'e kisha parë nga afër. U dëgjuan sérish hapa. Ajo u kthyte me një fustan të bukur vere, qepur thjeshtë, që i arrinte gjer te këmbët dhe i zbulonte vetëm duart. Kokën ia mbulonte një shami e bardhë. Pa u ulur, më pyeti:

— Të të bëj një kafe? Kam dhe lëng portokalli, po deshe.

— Të lutem, mos u bezdis.

Ajo u largua sérish, por në këtë e sipër, unë, arrita ta kundroja mirë. Fytyrën e kishte ca më të rrumbullakët se dikur, veç prapë ishte joshëse dhe rruhat mbi të nuk dukeshin. Në vend të freskisë dhe vrullit të mëparshëm rino, në tërë qenien e saj i këndohej urtësia dhe serioziteti i moshës. Po flokët, a i qenë thinjur vallë? Trajtat e trupit nën fustan të prishnin nga mendtë. Po pér atë Allah mend shkallova dhe unë! U rrëmbeva në vorbullën e një epshi të shfrenuar. Ah, të kisha ta ngjishja pas kraharonit e të shkriheshim bashkë që të dy me përqafime të zjarrta e të pasosura, si dikur! Por një zë i brëndshëm më porosiste:

— Kujdes, Halim. Se ti nuk e di se ç'ka në shpirt ajo në këtë caste! Ndoshta tash e mbrapa ajo ka vendosur t'i kushtohet vetëm mëmësisë dhe një jete të pastër e të ndershme. Ndaj fashite dufin tënd dhe kujdes se mos shkelësh në dërrasë të kalbur.

Ajo u kthyte me një tabaka të vogël sermi në do-

rë mbi të cilën qe shishja me lëngë portokalli. Tabakanë e vuri mbi një tryezë të gdhëndur me sedef dhe e afroi ndaj kolltukut tim.

— Të vura në siklet. Ulu dhe prehu ca. — fola.

Ajo ndënji në një divan karshi meje dhe bash atij çasti më tërroqi vëmendjen një fotografi dasme që i varej mbi krye. Dhe anash saj dy fotografi të tjera: në njérën Ali Jusufi, në tjetrën djemtë e tij me petka arabe. Aty për aty e humba: misioni po më vështirësohej.

— Gjene mirë që u kujtovë më në fund, për një të afërmmin tënd!

— E po s'ka lezet që të jemi në një mëhallë dhe të mos e shohim njeri-tjetrin.

— Të lumshin këmbët! Ende në ministri punon?

— Sapo dola në pension.

— U bëfsh njëqind vjeç! Po kush të bën hyzmet?

— Askush. Jetoj vetëm me muret e vjetra, — iu përgjegja me buzën në gaz.

— Qënkemi të dy njësoj, veçse mua më gjëzon një herë në javë një grua babaxhane dhe besnikë.

— Kurrë nuk del nga shtëpia?

— Rrallë, vetëm në raste të jashtëzakonshme.

— Vetminë mos ia urosh as hamit. Mua s'më bën derman as ajo kafeneja ku vete për të vrarë kohën, as edhe një mik që kam.

— Përveç televizorit ma shkelin shtëpinë edhe një dy fqinje, — pohoi ajo përmes një ofshame.

— Këto s'mjaftojnë.

— Gjithsesi, më mirë se pa gjë fare!

— Po djemtë, si ia çojnë?

— Feja vetë! Janë selitur atje përgjithmonë. Tani unë jam bërë me nipër e mbesa... Ç'ti bësh, ky që fati im...

Në këto fjalët e saj të fundit ndihej trishtimi.

— A u ke shkuar? — pyeta.

— Atje vetëm njëherë kam qenë, për haxhillëk...

— E po të lumtë, qënke bërë dhe haxhi, — vërejta i pikëlluar.

— Të njëjtën gjë të uroj dhe ty, — ma ktheu ajo, — Po t'u shkrep të vesh ndonjëherë, djemtë e mi do të të presin krahëhapur.

— Këtë e ka në dorë Allahu. A s'më thua, më shëndet si je?

— Po ti si je?

— Lavdi zotit, më mirë prishet.

— Edhe unë nuk ndihem keq, vetëm se ja, u shtërgova të vë dhëmbët.

— S'ka hiç rëndësi.

— Vetëm për një gjë i lutem Allahut: të më dërgojë një vdekje të bardhë.

— Po ti e ke jetën përpara! — thirra me zjarr. — Sa i lumtur jam që po të shoh!

— Edhe unë, gjithashtu. Vetëm se më vjen keq që je njeri pa njeri.

— Veç pak a shumë të dy njësoj jemi, ama.

— Desha të thëm, — vazhdoi ajo me të butë, — se duhej të ishe bërë me grua dhe me fëmijë.

— Fatit s'ke ç'i bën... — thashë i mërzitur.

Heshtëm që të mbusheshim me frymë. E piva të gjithë lëngun e portokallit dhe u mbulova i téri me djersë. Mendoja se mund ta kanalizoja bisedën ash tu siç më pëlqente, se do të derdhja në krahërorin e Meleqes gjithë pasionin tim të mbledhur pikë pikë gjatë tërë atyre viteve të gjata, se do të bëja këtë a do të bëja atë... kurse këtu s'dukej se do të mund të bëja ndonjë gjë nga këto. Përpara meje qëndronte një zonjë e rreptë, që s'pranonte të bëja asnjë shaka... Mbi kryet tona qenë varur ca porëtre

që na shikonin, e dukej sikur mernin pjesë edhe ata
në bisedë, duke mos lejuar asgjë jashtë nderit dhe
arsyes, e duke i dhënë takimit tonë një hije pikëlli-
mi. Ç'mendonte ajo vallë? A thua asnë nga ato kuj-
time shpirtrobëruese të së kaluarës sonë të bukur,
nuk po i ringjallej në kujtesë, nuk po i thoshte gjë,
nuk po i pëshpériste gjë? A i frenonte dot vallë ajo
mendimet ashtu sikundër frenoi edhe sjelljen? Sa
do të desha të rrokja në sytë e saj qoftë dhe një
aluzion të largët, një xixë mëndjelehtësie, një ma-
rrëzi fluturake, një fërfërimë buzëqeshjeje — kjo
do të më sqaronte për shumë gjëra. Por unë hasa
vetëm në një shikim serioz e ngushëllues, në një vë-
shtrim siç vështron një kushurirë të kushuririn, që
piqen aty nga perëndimi i jetës. A thua Meleqja e
dikurshme s'ka për t'u kthyer më kurri? Kështu apo
ndryshe, unë s'do të largohesha nga kjo shtëpi pa
ia arritur qëllimit. A thua frika do të më ndjekë kë-
mba-këmbës tërë jetën dhe asnëherë s'do të më lë-
rë t'i shpie gjërat gjer në fund? Kuturisa e pyeta:

— Nuk e di, në do pranoje që herë pas here ta
zbukuronim vetminë tonë, duke të parë?

— Derën e ke të hapur, — ma pat ajo qetë-qetë,
mandej u mëdysh një grimë e shtoi: — Por...

E pikasa se ç'fshihej pas këtij «por-i», ndaj
ndërhyra:

— Po ne jemi kushurinjë, mandej dhe mosha na
mbron nga thashethemet.

Ajo u topit.

— Domethënë nuk do që unë të vij te ti? —
ngulmova.

— Nuk e thashë këtë, — u përgjigj ajo aty për
aty.

— Ndofta ti je për një mënyrë të rreptë jetese.

— Kjo prapë s'na pengon ta mendojmë.

— Do të dëshiroja që ti të flisje me mua me sin-qeritetin e ditëve të vajzërisë.

— Unë ndryshe s'di të flas.

— Unë e ndiej të nevojshme praninë tënde, vet-mia më është bërë e padurueshme! — klitha me zjarr. — Se ti e di që përveç teje, unë s'kam kërkënd tjetër. Térë kohën vetëm pér këtë gjë mendoj.

Ajo buzëqeshi dhe me një fytyrë që iu mbulua tejpërtej nga një tis i purpurt, pëshpëriti:

— Të kuptoj.

— Që të dy, pra, kemi nevojë pér shoqërinë e njeri-tjetrit! — thashë, tanimë, i trimëruar.

Meleqja vuri buzën në gaz dhe nuk më dha asnjë përgjigje. Sakaq, m'u duk sikur ja, befas, qemë hedhur në të kaluarën.

— Vetmia është e rëndë, jeta është e hidhur, jam i përgjëruar pér diçka të re. Ja ti i paske ndërruar mobiljet...

— Në shtëpinë tonë térë orenditë janë të reja. Im shoq i ndjerë më la një shumë jo të vogël të holë. Vaidi më dhuroi takëmin e dhomës së gjumit. Bekriu, djali i dytë, — takëmin e dhomës së pritjes. Me paratë e mia bleva mobiljet e dhomës së ngrë-nies.

— Dhe këto çmimet e sotme nuk të tutin?

— Pensionin e kam mjaft të vogël, por Vaidi dhe Bekriu nuk më kanë lënë asnjëherë në baltë. Po ti si i ke punët?

— Mundohem të mbahem, megjithëse kush e çan kokën pér ne pensionistët? Por më është shkrepur ta nis jetën nga e para.

— Tani që dole në pension?

— Po me shëndet jam mirë, anglishten e zotë-roj, përvoja e punës administrative s'më mungon.

Them ta provoj shansin në një shoqëri private që merret me investime.

- Atje s'paguajnë keq.
- Kam varur shpresa të mëdha te kjo gjë.
- Një ide e shkëlqyer.
- Më vjen mirë që ty të pëlqen!

Heshtëm sërish dhe unë e mblojha se duhej t'i lija lamtumirën.

- E po, boll ndënja.

Ajo për mirësjellje m'u lut të rrija dhe ca, po unë u ngrita dhe i zgjata dorën.

Çapisja nëpër rrugën e qetë të mbrëmjes duke thithur ajrin e freskët të verës. Ndonëse nuk ia arrita synimit, ende shpresa s'më ishte shuar. Për në kafene isha nisur, tanimë, në një gjëndje tjetër shpirtërore. Në këto e sipër më vegoi Hamada at Tartushi me atë fytyrë që i qeshte vesh më vesh.

— Po ti qënke bërë si djalë i ri. Kurrë s'të kam parë ndonjëherë si sot.

I pëershkova ç'më kishte ngjarë me Meleqen, duke i përjetuar sërish ato emocione.

— Situata paraqitet optimiste, — shfaqi mendimin Hamada, — po ti ç'thua?

U mendova pak dhe iu përgjigja:

— Dora-doras suksesi është i siguruar vetëm pësëdhjet përqind. Jo më tepër.

— Ke të drejtë.

— Po të donte ajo, edhe kjo vizitë mund të ishte e para dhe e fundit.

— Padyshim.

— Me siguri ajo e ka nuhatur qëllimin e vizitës tënde.

— Them se po.

— Besomë mua, unë gratë i kuptoj më mirë se ti.

— E ke me gjithë mend kur thua se ajo është

ende në formë?

— Të betohem, ajo ende të bën pér vete! — e sigurova pa më të voglën mëdyshje.

— Dua të të lajmëroj pér një gjë: mos u gënje me lugë të zbrazët, — thaq ai më të qeshur. — Pamja e jashtëme në këtë moshë flet pak. Me fustan ajo dhe mund të të josh veç po ta zhveshësh laku-riq atëhere do të habitesh me atë trupin e saj rrëmbla-rrëmba si ato rrugët e sotme. Ndaj po të kë-shilloj që, po e fute në dorë, dashurinë ta bëshë në errësirë të plotë.

U shkriva së qeshuri dhe i thashë:

— T'ia arrijmë qëllimit, mandej shohim e bëjmë.

Në të kthyer më kaploj një mall a brengë e tmerri shme dhe shtëpia ime m'u urrye akoma më shumë. Ah, lele, sikur ta digjin! Në ditët që rodhën, paskëtaj, nuk ndieja më kënaqësi as nga televizori, as nga kafeneja. Rroja vetëm me një shpresë; kur t'i shkoja prapë pér vizitë asaj. Mbas një javë ishte ende mjaft herët, të prisja një muaj të tërë do të torturohesha, ndaj vendosa ta përsërisja vizitën mbas dy javësh. Gjatë kësaj kohe mësova se në një nga filialet e shoqërisë «Gjeneral elektrik», që udhë-hiqte ndërtimin e stacioneve të pastrimit të ujëra-ve, kishte një vend bosh. Një punë e përkohëshme kjo, vetëm pér tre vjetë që paguhej katërqind lira egjiptiane në muaj, përveç udhëtimit falas. Bëra lutjen pér konkurs. Fitoi një vajzë, por drejtori ma afroi mua detyrën në degën administrative me një pagë prej treqind lirash në muaj. Pranova, pasi më leverdiste plotësisht. Vetëkuptohet, me këto të ardhura, unë s'mund të bartesha në një rajon ndërtimesh moderne, po pér të ngrënë e pér të veshur do të isha shumë më mirë. Mbas dy javë pritjeje u

nisa nën mbrojtjen e muzgut te Meleqja ime e dashur: durimshterur, pasionqndezur dhe më i vendosur se kurrë, si dhe me bindje se një burri në moshën time nuk i ka hije të humbas toruan, si të ishte një çunak dhe t'i vijë rëndë, si të ishte një djalosh. Kur Meleqja më hapi derën e dhomës së pritjes iu luta të shkonim në një dhomë tjetër, kinse për ta ndier vehten më të shpenguar, por e vërteta ishte se nuk doja të shikoja fotografitë e varura në mur.

— Ti më ktheve gjëzimin e jetës, — iu rrëfeva.

— Mos e tepro, — buzëqeshi ajo.

— Fillova punë në «Xheneral elektrik» — kumtova i kënaqur.

— Urime!

Si i tregova për pagën dhe për ca vogëlima të tjera, shtova:

— Tani edhe ëndërrën time mund ta përbush. Me ç'duket, ajo nuk më kuptoi.

— Do ta kesh vështirë të mbaresh në ndonjë shtëpi të re. Mendoje mirë këtë gjë.

— Për mua shtëpia nuk është kryesorja, — thashë.

— Vërtet?

— Problem serioz uën kam martesën.

— Martesën? — foli ajo duke fshehur habinë e saj me mjeshtëri.

— Me shëndet jam qiqër, — thashë me një bindje të plotë.

— Ta shtoftë Allahu akoma më shumë! — tha ajo duke buzëqeshur e turbulluar.

— Desha të di mendimin tënd.

— E pse jo? Madje njerëzit martohen në një moshë më të madhe se ti.

— Edhe unë ashtu them.

— Lejomë tē tē gjej një grua tē përshtatësh-me — tha ajo e gëzuar.

— Ç'domethenë grua e «përshtatëshme»?

— E po tē jetë serioze dhe jo më pak se dyzet vjeçë.

— Në këtë rast ajo do tē jetë vejushë ose e ndarë.

— E çë pastaj?

— Dhe me fëmijë e ndofta me tē mitur.

— E po, me këtë do pajtohesh.

Duke parë drejt, në ato sytë e saj tē përhumbur vijova:

— S'është nevoja tē kërkosh, unë e di vetë se ç'më duhet.

— Ç'do tē thuash me këtë? — pyeti ajo me tē mbajtur goje.

— Meleqe, — thash unë me zë tē shtruar e lutes, — ajo që më duhet mua je ti.

Ajo uli sytë dhe u mrrol. Po unë isha këmbëngulës.

— Ç'mund tē më thuash?

— Për këtë paske ardhur?

— Po.

— Po këto janë turpe, po këto janë marrëzira.

— Marrzira?

— Po çfarë sipas teje?

— Asnjë marrëzi s'ka në këtë mes; kjo është thjesht një nevojë e natyrshme.

— As që më shkon ndërmend tē martohem — tha ajo me një zë fërgëllues.

— Mos harro se kjo ka qenë një èndërr jonë e flaktë.

— Tani tē gjitha këto i përkasin së kaluarës, — tha ajo e tronditür.

— Por e kaluara është kthyer tek unë me tërë forcën e saj — klitha i flakëruar.

— Ti as vet nuk e kupton se çfarë thua. Vetmja të ka humbur arsyen. Endrrat së shpejtë do të të shuhën vetvetiu.

— Unë e di se ç'kërkoj.

— Jo, unë nuk e mbuloj veten me turp. — tha ajo e emocionuar.

— E ç'të mbeti në gojë kjo fjalë e mallkuar?

— Duhet t'i shikojmë gjërat esëll. Ti harron se unë jam nënë dhe gjyshe.

— Në fillim njeriu e ka të vështirë të mësohet, por pastaj, dalëngadalë bën atë që e bën të lumtur, pa u merakosur për arsyen, — thashë me përzemërsi.

Ajo përpéliti qepallat tërë përvuajtësi dhe murmuriti:

— Mos më hiq qetësinë shpirtërore.

Në ato çaste m'u duk se ajo po hahej me mua jo vetëm si nënë, si gjyshe e si kushurirë, por edhe si grua. Brofa nga vendi dhe eca drejt saj, që t'i ulla sha pranë, si dikur, por ajo u sbraps dhe vikati e pataksur:

— Mos më prek!

Kjo klithmë më dogji si të qe një flakërimë fytërës. Për një hop shtanga krejt i dëshpëruar dhe i hutuar. Duke ikur bërbëlita:

— Allahu të ruajt!...

21.

Nuk vajta në kafene, as në shtëpi. Brodha gjatë pa qëllim duke pushuar kur e kur lokaleve, që hasja rrugës. Ndaj agimit u ktheva në gropën time të varrit.

Të nesërmen tek po ecja si ngahera rrugës për në kafenenë «Mbrothësia» ngrita sytë nga ballkoni i saj. Ajo po qëndronte para dërës dhe m'u duk sikur po shikonte nga unë. Për mirësjellje e përshëndeta më kokë. Befas ajo ma bëri me dorë. Më ngriu zemra. Stepa atje e s'lëviza dot më. Ç'do të thoshte kjo? Ajo u zbraps, ma bëri sërisht me dorë dhe u fut brenda.

I dashë kësaj shenje kuptimin që ma donte zemra dhe me këmbët që mezi më mbanin nga gëzimi, çava rrugën mespërmes. Kësaj here nuk prita së t'u errej e t'u vinte mbrëmja.